



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 710 Akti

Nr. 716 Vendimi
Tiranë, më 20.11.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko Kryesuese
Alma Faskaj Relatore
Xhensila Pine Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 17.11.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Rovena Zoto**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Alma Faskaj, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Rovena Zoto, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e

hedhur në datën 15.12.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Në përfundim të shortit rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Rovena Zoto, do të shqyrtohet nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Pamela Qirko dhe Xhensila Pine.

3. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

4. AKSIK-ja hartoi me kërkesën e Komisionit përditësim të raportit¹ në lidhje me subjektin dhe me shkresën nr. *** prot., datë 05.10.2023 përcolli raportin e përditësuar, të deklasifikuar me vendimin nr. *** të KDZH-së, në të cilin konkludohet se: *“...në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Rovena V. Zoto, gjykojmë që për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin tuaj nën dritën e informacioneve të tjera që mund të dispononi si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit”*.

5. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

6. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 1, datë 21.12.2020, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, për të tria kriteret, bazuar në pikën 1 të nenit 4 të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesuese e trupit gjykues komisionere Pamela Qirko. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

7. Në datën 7.11.2023, trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Rovena Zoto, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes.

8. Në datën 7.11.2023, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, duke i kaluar barrën e provës për sa ka rezultuar nga hetimi dhe duke i dhënë të drejtën të njihet me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe të paraqesë shpjegime/prova shtesë brenda datës 15.11.2023.

9. Në datën 8.11.2023, subjekti i rivlerësimit u njoh me materialet e dosjes.

10. Në datën 14.11.2023, subjekti i rivlerësimit dërgoi në rrugë elektronike (me *email*) shpjegimet e saj mbi rezultatet e hetimit kryesisht, të shoqëruara me dokumentacion.

11. Në datën 15.11.2023, me vendimin nr. 3, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Rovena Zoto, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe me anë të postës elektronike e njoftoi se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 17.11.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

12. Në datën 17.11.2023 u zhvillua seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte e pranishme.

II. SEANCA DËGJIMORE

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 7.9.2023.

13. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Rovena Zoto, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger.

14. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit, znj. Rovena Zoto, shprehu qëndrimin e saj lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

15. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

16. Znj. Rovena Zoto ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit ndaj saj, duke u përgjigjur dhe duke dërguar dokumentacionin dhe shpjegimet përkatëse sipas kërkesës së Komisionit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

17. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

18. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

19. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

21. Në kreun VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

22. Por, referuar vendimit nr. 2/20171 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

23. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, që gjenden në dosjen e subjektit dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i

rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

24. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Rovena Zoto, e cila është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2009, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

25. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave privatë për vitet 2009 – 2016 dhe në datën 28.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhurave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të ardhurat e prindërve të bashkëshortit;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

26. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting* 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitet 2009 – 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit e, në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore; (e) deklaratimet në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

27. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesit.

Personat e lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit që janë hetuar

28. Për efekt të procesit të rivlerësimit, personat që janë hetuar si të lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit janë si vijon: z. E.Z, bashkëshorti (bashkëshort nga data 10.6.2011), konsiderohet person tjetër i lidhur; V.B dhe E.B, prindërit e subjektit, vëllai i subjektit E.B, pasi kanë qenë në përbërje familjare me subjektin deri në momentin e lidhjes së martesës së saj, si dhe SH.Z e D.Z, prindërit e bashkëshortit, për shkak se subjekti ka deklaruar të drejtën e përdorimit të një apartamenti në pronësi të nënës së bashkëshortit.

Pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur

1. Tokë bujqësore e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* 2017, në bashkëpronësi në emër të kryetarit të familjes bujqësore, babait të saj V.B, e përfituar si anëtare e familjes bujqësore në bazë të ligjit nr. 7501, “Për tokën”, ndodhur në z. k. ***, fshati K, Lushnjë, me nr. pasurie përkatësisht: ***, arë me sip. 45 m² sipas aktit nr. ***, ndërsa sipas LN Shtator *** sipërfaqja është 187 m²; ***, vresht me sip. 400 m²; ***, arë me sip. 2.650 m², si dhe ***, arë me sip. 903 m², sipas LN Shtator ***, bashkëpronare në pjesë takuese 25%.

Fakte nga hetimi administrativ kryesisht

1.1 Nga hetimi administrativ rezultoi e provuar se në emër të shtetasit V.F.B (babai i subjektit) si kryefamiljar, kryetar i familjes bujqësore, ka dalë Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi nr. ***, datë 19.2.2001, sipas të cilit ai ka përfituar tokë me sipërfaqe totale 4.080 m², e ndodhur në fshatin K, Lushnjë. Këto pasuri janë të regjistruara në sistemin e ri të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe janë pasuritë: nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit arë me sip. 45 m²; nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit vresht me sip. 400 m²; nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit arë me sip. 2.650 m², fshati K, Lushnjë; nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit arë me sip. 903 m².

1.2 Rezultoi e provuar se pasuritë janë deklaruar për herë të parë nga subjekti në DIPP-në e vitit 2015, në përmbajtje të njëjtë si në deklaratën *Vetting*, duke deklaruar: “*Tokë bujqësore e llojit arë dhe vresht, fituar me ligjin nr. 7501, “Për tokën”, sipas AMTP-së nr. ***, në emër të kryetarit të familjes bujqësore V.B, ndodhur në z. k. ***, me nr. pasurie ***, ***, ***, ***, me sipërfaqe totale 4.140 m². Pjesa në përqindje: bashkëpronare në ¼ pjesë të kësaj pasurie*”.

1.3 Në përfundim, Komisioni vlerëson se: (i) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin pasurinë tokë bujqësore; (ii) këto pasuri janë fituar nga subjekti para fillimit të detyrës sipas ligjit nr. 7501, “Për tokën” dhe subjekti është bërë bashkëpronare e tyre si anëtare e familjes bujqësore.

2. Në përdorim apartament banimi me sip. 121 m², ndodhur në lagjen “****”, rruga “****”, pallati pranë bar “****”, kati ***, Lushnjë. Subjekti ka deklaruar se të drejtën e përdorimit e kanë marrë nga prindërit e bashkëshortit, të cilët e kanë porositur apartamentin me kontratë porosie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.11.2014, pranë noteres O.D, Dhoma e Noterisë Lushnjë. Vlera: 30,250 euro, sipas kontratës së porosisë datë 19.11.2014, lidhur midis vjehrrës D.B dhe sipërmarrësit “LL” sh.p.k.

Fakte nga hetimi administrativ kryesisht

2.1 Subjekti dhe personi i lidhur e kanë deklaruar për herë të parë të drejtën e përdorimit të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*, por rezultoi se ata e kanë deklaruar këtë pasuri si adresë banimi në DIPP-të e viteve 2014 – 2016.

2.2 Gjatë procesit të rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit standard në lidhje me adresat e banimit, subjekti ka deklaruar se nga qershori i vitit 2014 deri në qershor të vitit 2021 ka banuar në një apartament të ndodhur në lagjen “****”, rruga “****”, nd. ***, hyrja ***, ap. ***, të cilën prindërit e bashkëshortit e kanë porositur tek shoqëria “LL” sh.p.k.

2.3 Rezultoi e provuar se me kontratën e porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.11.2014², me palë sipërmarrëse shoqëria “LL” sh.p.k. dhe palë porositëse D.B (vjehrra e subjektit), kjo e fundit ka porositur një apartament me sip. 121 m² në total dhe 105.6 m² (89.5 m² + ballkoni 16.1 m²) sipërfaqe e brendshme, në lagjen “****”, Lushnjë, kundrejt çmimit 250 euro/m², vlera totale 30,250 euro. Sipas kontratës (neni IV), vlera e apartamenti është likuiduar e gjitha *cash* në dorë, sipas mandateve bashkëlidhur kontratës.

² Aneks nr. 4/9 në dosjen e ILDKPKI-së.

2.4 Për një hetim të plotë dhe gjithëpërfshirës, Komisioni kërkoi informacion nga subjekti ndërtues “LL” sh.p.k., i cili shpjegoi³ se sipas kontratës së porosisë së sipërcituar është shlyer shuma prej 30,250 euro, duke bashkëlidhur të njëjtën mandatpagesë.

2.5 Rezultoi e provuar si nga firma ndërtuese ashtu edhe nga subjekti se kjo pasuri nuk është ende e regjistruar për shkak të konfliktit gjyqësor me pronarët e truallit.

2.6 Nga hetimi rezultoi e provuar⁴ se shtetasja D.B ka lidhur kontratë furnizimi me ujë me UK Lushnjë sh.a., kontratë e tipit familjare, me nr. ***, në lagjen “***”, Lushnjë. Faturimet për këtë kontratë kanë filluar në korrik të vitit 2014, ndërkohë nuk ka kontratë furnizimi të lidhur midis shtetasës D.B dhe FSHU/OSHEE. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti shpjegoi se nuk është realizuar ende ndryshimi i kontratës së furnizimit nga firma “LL” sh.p.k. tek porositësi, pavarësisht aplikimit të kryer.

2.7 Në datën 23.1.2017 është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore⁵ të së ndjerës D.B, e cila ka ndërruar jetë në datën 18.10.2016⁶, duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë shtetasit SH.Z (vjeherri i subjektit), E.Z (bashkëshorti i subjektit) dhe O.SH.S (Z) (kunata e subjektit).

2.8 Nga hetimi rezultoi e provuar se subjekti dhe bashkëshorti e kanë përdorur këtë apartament nga muaji qershor 2014 dhe në momentin e largimit të saj në Tiranë bashkë me familjen në të jeton dhe mirëmbahet nga vjeherri i saj.

2.9 Komisioni hetoi nëse ekzistonte konflikt interesi i subjektit për shkak të detyrës me firmën e ndërtimit “LL” sh.p.k. dhe/ose ortakët/administratorët e kësaj shoqërie dhe nuk rezultoi që subjekti të ketë ndjekur materiale kallëzuese apo procedime penale që kanë lidhje me personat e sipërpërmendur⁷.

2.10 Referuar të dhënave të EKB-së⁸ rezulton se apartamenti është blerë 172,728 lekë më shumë se mesatarja e shitjeve, ose 0.04 herë më shtrenjtë⁹ se vlerat mesatare të shitblerjes së apartamenteve në tregun e lirë në qytetin e Lushnjës në këtë vit.

Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë

2.11 Subjekti dhe bashkëshorti nuk e kanë deklaruar burimin e kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*. Gjatë procesit të rivlerësimit subjekti është pyetur¹⁰ për burimin e pasurisë, për të cilin sqaroi se sipas informacionit që ka marrë nga vjeherri i saj SH.Z (pasi vjeherra ka ndërruar jetë në vitin 2016) kjo pasuri është krijuar pjesërisht me të ardhurat e realizuara nga shitja e një apartamenti të mëparshëm të ndodhur po në qytetin e Lushnjës, një hua prej 20,000 euro nga tezja e personit të lidhur, znj. F.L, si dhe kursimet e tyre.

2.12 *Lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit*

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 3.7.2023 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 3.7.2023).

⁴ Nga shkresa nr. *** prot., datë 2.6.2023, e UK Lushnjë sh.a. (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 5.6.2023).

⁵ Nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.1.2017, notere E.S, Lushnjë.

⁶ Referuar dëshmisë së trashëgimisë bashkëlidhur kontratës së porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.11.2014, aneks nr. 4/9.

⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 26.6.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 29.6.2023) dhe shkresë nr. *** prot., datë 29.6.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 29.6.2023).

⁸ Udhëzim nr. 2, datë 6.8.2014, çmimi për metër katror në qytetin e Lushnjës 38,500 lekë.

⁹ Vlera e shitblerjes së apartamentit me sip. 89.5 m² në qytetin e Lushnjës sipas referencave të EKB-së është 4,065,600 lekë, ndërsa nëna e bashkëshortit e ka blerë në vlerën 30,250 euro ose 4,238,328 lekë.

¹⁰ Pyetësor nr. 2, pyetja nr. 4.

2.12.1 Rezultoi e provuar se apartamenti me adresë rruga “***”, me nr. pasurie ***, z. k. ***¹¹, i është shitur shtetasit I.S në datën 21.1.2011¹². Referuar kësaj kontrate, vlera e apartamentit të shitur është 2,554,524 lekë, ndërkohë nga subjekti, sipas deklarimeve të vjehrrit dhe dokumenteve bankare të analizuara nga Komisioni, vlera reale e shitjes së këtij apartamenti ka qenë 5,000,000 lekë. Kjo shumë është depozituar në bankë prej blerësit I.S në dy këste, përkatësisht në datën 11.8.2010 është depozituar shuma prej 1,000,000 lekësh, me shënimin “I.S për SH.Z-për blerje shtëpie”, ndërsa kësti i dytë është depozituar në datën 21.1.2011, në shumën 4,000,000 lekë, me shënimin “I.S për SH.Z-për blerje shtëpie”.

2.12.2 Nga totali i vlerës së transferuar prej 5,000,000 lekësh, shtetasi SH.Z tërheq vlerën 150,000 lekë në datën 21.1.2011 dhe vlera 4,850,000 lekë investohet si depozitë kursimi në datat 12.8.2010 dhe 21.1.2011, duke u mbajtur e tillë deri në datën 23.5.2011. Në datën 23.5.2011 është transferuar vlera 3,000,000 lekë, me përshkrimin “SH.Z për sh.p.k. A-likuidim detyrimi për blerje apartamenti”. Nga kjo shumë, vlera 2,600,000 lekë është kthyer nga shoqëria “A” sh.p.k. në vitin 2016 në llogarinë e shtetasit SH.Z pranë Credins Bank¹³, me përshkrimin “Kthim paradhënie blerje ap. për prishje kontrate shitblerjeje”. Nga të ardhurat nga shitja e apartamentit pas transferimit të vlerës 3,000,000 lekë, vlera e mbetur prej 1,910,358 lekësh është mbajtur si depozitë kursimi në BKT, duke e rinovuar disa herë deri në datën 16.7.2014, kur është tërhequr shuma 1,600,000 lekë ~ 11,420 euro. Subjekti shpjegon me pyetësorin nr. 2 se kjo shumë ka shërbyer si burim për apartamentin e blerë në datën 16.7.2014 nga shtetasi SH.Z. Nga sa rezulton më lart, vjehri i subjektit mund të ketë përdorur si burim vetëm vlerën 150,000 lekë (rreth 1,080 euro) të tërhequr në datën 21.1.2011. Kjo vlerë është marrë në konsideratë nga Komisioni në analizën financiarë të burimit të krijimit.

2.13 *Lidhur me të ardhurat e përfituara nga huaja nga tezja e personit të lidhur, znj. F.L*

2.13.1 Komisioni hetoi në mënyrë të plotë e të gjithanshme lidhur me mundësinë e tezes së bashkëshortit të subjektit për t’i dhënë këtë hua motrës së saj.

2.13.2 Rezultoi e provuar se tezja dhe bashkëshorti i saj, përkatësisht F e A.L, kanë ushtruar aktivitet tregtar në Tiranë ndër vite.

2.13.3 Sipas dokumentacionit të përcjellë në Komision nga subjekti i rivlerësimit¹⁴, nga Drejtoria Rajonale Tiranë rezulton se z. A.L ka qenë i regjistruar me NIPT *** dhe znj. F.L me NIPT ***. Nga dokumentacioni bashkëlidhur shkresave¹⁵ Komisioni informohet se shtetasi A.L ka regjistruar aktivitetin tregtar në datën 15.4.2004 dhe është çregjistruar në datën 3.3.2010. Gjithashtu përcillet dokumentacion për shlyerjen e taksave vendore, kontributeve, kontratë qiraje për ambientin e shërbimit etj. Ndërsa për subjektin tregtar “F.L” rezulton se është regjistruar në datën 1.3.2010 dhe nga data 15.12.2014 rezulton me status pasiv. Edhe për këtë subjekt tregtar përcillet vërtetim “raporti i pagesave” për taksat vendore dhe taksa e biznesit të vogël të shlyera prej saj.

2.13.4 Komisioni i kërkoi DRT-së Tiranë informacion financiar mbi aktivitetin tregtar të shtetasës F.L,¹⁶ e cila ka informuar se subjekti tregtar i regjistruar me NIPT *** me aktivitet “Tregti me pakicë e kompjuterëve, njësi periferike dhe softwareve” është regjistruar në sistem në datën 1.3.2010 dhe nga ana e saj nuk janë dorëzuar deklarata të ardhurash. Aktualisht ky subjekt rezulton me detyrime të papaguara dhe me status pasiv nga data 15.12.2014.

¹¹ Këtë apartament shtetasi SH.Z e kishte blerë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.2.2009, ngashtetasja N.SH, në vlerën 2,647,400 lekë, përcjellë në Komision nga subjekti me përgjigjet e pyetësorit nr. 3.

¹² Me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.1.2011, notere O.D, Lushnjë, e përcjellë nga noterjame shkresën nr. *** prot., datë 22.6.20223.

¹³ Shkresë nr. *** prot., datë 11.3.2021, e Credins Bank.

¹⁴ Email datë 15.9.2023 dhe 19.9.2023 “Dokumente shtesë në vijim përgjigjeve nr. 3”.

¹⁵ Gjithashtu, edhe nga fajta zyrtare e QKB-së rezulton se aktiviteti tregtar i znj. F.L, person fizik, është regjistruar në datën 1.3.2010 me NIPT *** dhe objekt tregti me pakicë abazhurë.

¹⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 31.7.2023, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

2.13.5 Në tabelën e mëposhtme është paraqitur xhiroja e parashikuar vetëm për vitet të cilat ka deklarim nga subjektet tregtare të sipërcituara, si dhe fitimi neto i llogaritur me marzhin e fitimit të përdorur në praktikën e Komisionit.

Subjekti tregtar	Viti	Qarkullimi i parashikuar	Marzhi i fitimit sipas praktikës së Komisionit	Fitimi neto
A.L	2004	2,250,000 lekë	30%	675,000 lekë
	2005	4,500,000 lekë		1,350,000 lekë
	2006	6,666,666 lekë		2,000,000 lekë
	2008	3,011,570 lekë		903,471 lekë
F.L	n/a	n/a		n/a
TOTALI		16,428,236 lekë		4,928,471 lekë ose 35,176 euro

2.13.6 Gjithashtu, Komisioni iu drejtua edhe subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetësor nr. 6, për dhënie informacioni nëse shtetasit F.L dhe A.L kanë lidhur kontrata porosie apo shitblerjeje pasurish të paluajshme të regjistruara ose jo pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës pas vitit 2009.

2.13.7 Për një hetim të plotë Komisioni hetoi pranë ASHK-së¹⁷ për pasuri të paluajshme në pronësi të z. A.L ose znj. F.L dhe për veprime të tjera juridike si kontrata etj., të lidhura nga këta shtetas përpara noterëve publikë¹⁸. Nga përgjigja e ASHK Tirana Rurale 2¹⁹ rezultoi se shtetasi A.L ka pasur në pronësi pasurinë arë me sip. 525 m², me vendndhodhje Y, Tiranë, fituar me kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.3.2000, me çmim blerjeje 1,550,000 lekë, e cila është shitur prej tyre në çmimin 2,000,000 lekë me kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr.*** kol., datë 12.1.2001. ASHK Lushnjë²⁰ informon se këta shtetas kanë pasur në bashkëpronësi një apartament me sip. 60 m², blerë me kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.6.1994, me çmim blerjeje 1,660 lekë, me palë shitëse Komisionin e Privatizimit Lushnjë. Ky apartament i është shitur me kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.7.1996, shtetasit H.L, me vlerë 600,000 lekë. Ndërsa ASHK Tirana Jug²¹ informon se shtetasit F dhe A.L kanë në pronësi apartamentin me sip. 75 m², i fituar me kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.9.2001, me vlerë blerjeje 2,000,000 lekë.

2.13.8 Në analizë të provave të administruara nga institucionet publike dhe ato financiare, disa prej tyre edhe të klasifikuara, të administruara në dosje, rezulton e provuar se shtetasja F.L dhe bashkëshorti i saj A.L kanë pasur mundësi t'i japin një hua prej 20,000 euro vjehrrës së subjektit. Gjithashtu, këtë e përforcon edhe mundësia që vjehri ka pasur për ta shlyer këtë hua pas prishjes së një kontrate tjetër shitblerjeje apartamenti.

2.14 Lidhur me mundësinë e prindërve të bashkëshortit të subjektit për kursime

2.14.1 Komisioni, në analizë të mundësisë së prindërve të bashkëshortit për të kursyer, mori në konsideratë burimet ligjshme të tyre, të ardhurat e prindërve të bashkëshortit nga aktiviteti tregtar, si dhe të ardhurat nga pensioni.

2.14.2 Komisioni hartoi analizën financiare për burimin e krijimit të pasurisë, duke përfshirë të ardhurat e ligjshme si më poshtë:

Vitet	Analiza financiare kumulative 2007 – 1.11.2014
TË ARDHURAT	11,262,723 lekë
Të ardhura nga paga të znj. D.B për periudhën 2007 – nëntor 2014	1,335,772 lekë
Të ardhura nga paga z. SH.Z për periudhën 2012 – nëntor 2014	476,951 lekë

¹⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 6.11.2023, e ASHK Drejtoria e Përgjithshme.

¹⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 2.11.2023, e RNSH-së.

¹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 6.11.2023, e ASHK Tirana Rurale 2.

²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 6.11.2023, e ASHK Lushnjë.

²¹ Shkresë nr. *** prot., datë 6.11.2023, e ASHK Tirana Jug.

Të ardhura nga shitja e apartamenteve	9,450,000 lekë
PASURI	7,197,400 lekë
Blerja e apartamenteve	6,647,400 lekë
Ndryshimi i likuiditete në sistemin bankar	550,000 lekë
SHPENZIMET	2,294,007 lekë
Shpenzime jetike për 2 anëtar të familjes	2,294,007 lekë
Rezultati financiar	1,771,316l ~ 12,642 euro

2.14.3 Sa më lart, rezulton se prindërit e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit kanë pasur mundësi të kursejnë vlerën 12,642 euro, e cila është përdorur si burim për blerjen e apartamentit.

2.15 Në përmbledhje të analizës së burimit të pasurisë, Komisionit i rezultoi se prindërit e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit kishin mundësi financiare për krijimin e pasurisë.

Burimi i krijimit	Të ardhura të ligjshme të rezultuara nga analiza e Komisionit
Të ardhura nga shitja e pasurive të mëparshme	150,000 lekë ~ 1,080 euro
Hua në vlerën 20,000 euro nga shtetasit F dhe A.L	20,000 euro
Kursimet e prindërve të bashkëshortit	12,642 euro
Totali	33,722 euro

2.16 Trupi gjykues, në vlerësim të faktit se subjekti e ka deklaruar si adresë banimi këtë pasuri në deklaratat periodike vjetore, si dhe në një analizë shteruese të burimeve të ligjshme për krijimin e saj nga ana e vjehrrës së subjektit, konkludoi se nuk krijohen dyshime për të drejta të tjera të subjektit mbi këtë pasuri.

2.17 Në përfundim, Komisioni vlerëson se: (i) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin përdorimin e kësaj pasurie dhe nuk krijohen dyshime për të drejta të tjera të subjektit mbi këtë automjet; (ii) personi tjetër i lidhur ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie.

3. Vlera monetare në llogarinë rrjedhëse nr. *,** hapur pranë Credins Bank si llogari kreditimi page nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Vlera: 64,796 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Fakte nga hetimi administrativ kryesisht

3.1 Subjekti fillon të deklarojë gjendje të llogarisë pranë Credins Bank në DIPP-në e vitit 2010 e në vijim deri në DIPP-në e vitit 2016.

3.2 Credins Bank²² ka konfirmuar llogari page në emër të znj. Rovena Zoto, me gjendje në datën 28.1.2017 në vlerën 64,796 lekë. Kjo llogari bankare rezulton e hapur prej datës 5.1.2010 dhe nga kjo datë janë transferuar pagat e subjektit të rivlerësimit nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më pas nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe vlerat e transferuar nga sigurimet shoqërore për lejet e lindjes.

3.3 Në përfundim, Komisioni vlerëson se përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit për gjendjen e llogarisë pranë Credins Bank me burimin e krijimit të vlerës së saj.

4. Gjendje në llogari pranë fondit për pensionin vullnetar pranë Credins Invest

- Subjekti deklaroi: *“Gjendje në llogari pranë fondit për pensionin vullnetar “S Pensions”, me nr. kontrate ***, në shumën 1,008 lekë, me burim nga paga. Vlera: 1,008 lekë Pjesa takuese: 100%”.*

²² Shkresë nr. *** prot., datë 11.3.2021, e Credins Bank sh.a.

- Bashkëshorti deklaroi: “Gjendje në llogari pranë fondit për pension vullnetar “S Pensions” me nr. kontrate ***, në shumën 3,017 lekë, me burim nga puna si avokat. Pjesa takuese: 100%”.

Fakte nga hetimi administrativ kryesisht

4.1 Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti deklaroi: “Të ardhura nga puna si prokurore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, të kaluara në llogarinë rrjedhëse paga marrëse pranë Credins Bank. Vlera: 1,115,689 lekë. Gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2016 ka qenë 10,967 lekë. Prej pagës, 1,000 lekë janë kaluar pranë fondit për pension vullnetar “S Pensions” me nr. kontrate ***,.” Ndërsa bashkëshorti deklaroi: “Fitimi i realizuar nga puna si avokat, biznes me NIPT ***. Gjendja e llogarisë së biznesit pranë BKT-së në datën 31.12.2016 ka qenë 484,853 lekë. 3,000 lekë janë kaluar pranë fondit për pension vullnetar “S Pensions” me nr. kontrate *** në Credins Bank”.

4.2 Credins Invest²³ ka konfirmuar se znj. Rovena Zoto është kliente në Fondin e Pensionit Credins që prej datës 11.11.2016 dhe deri në datën e kthimit të përgjigjes nga institucioni, 1.2.2021, zotëron kuota në fondin e pensioneve në shumën totale 40,211 lekë. Bashkëshorti ka çelur fondin e investimit në datën 11.11.2016 dhe ka realizuar dy derdhje me vlerë 1,000 lekë secila për vitin 2016 dhe dy shuma të tjera prej 1,000 lekësh secila në deri në datën 2.2.2017. Vlera totale në datën e kthimit të përgjigjes nga institucioni është 4,676 lekë.

4.3 Si burim për krijimin e vlerës së mësipërme të fondit të pensionit të subjektit të rivlerësimit ka qenë blerja e kuotave prej 1,000 lekësh çdo muaj nga data e krijimit, me burim transfertat nga llogaria e pagës e subjektit pranë Credins Bank.

4.4 Në përfundim, Komisioni vlerëson se deklarimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me fondin e investimit të tyre pranë fondit vullnetar të investimit S Invest është i saktë dhe nuk paraqiten problematika në lidhje me procesin e rivlerësimit.

5. Gjendje kursimesh cash të deklaruara në deklaratën Vetting

- Subjekti deklaroi në deklaratën e pasurisë: “Vlera monetare në gjendje cash, me burim krijimi dhurimi nga nëna ime E.B. Vlera: 500,000 lekë. Pjesa takuese: 100%”.
- Bashkëshorti deklaroi në deklaratën e pasurisë: “Vlera monetare në gjendje cash, me burim krijimi nga pagat ndër vite, vlera 800,000 lekë. Zotëroj 100%”.

Fakte nga hetimi administrativ kryesisht

5.1 Subjekti dhe bashkëshorti e kanë deklaruar gjendjen cash në mënyrë të saktë. Në analizë të këtyre deklaratave periodike, bashkëshorti i subjektit, në DIPP-në e vitin 2011, pas lidhjes së martesës me subjektin, nuk deklaroi kursime cash dhe as pakësim apo shtesë të tyre, por deklaroi në seksionin e pasurisë “Të ardhura nga emigracioni 2,000,000 lekë” dhe “Të ardhura të realizuara nga dalja në reformë policore, gusht 2007 – korrik 2009, vlera 780,000 lekë”. Ky deklarim ka pasaktësi në rubrikën që është plotësuar, pasi nuk është bërë pikërisht në rubrikën në të cilën bëhet deklarimi i gjendjes cash.

5.2 Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të gjendjes cash dhuruar nga nëna para marrjes së detyrës

5.2.1 Me deklaratën e datës 26.1.2017²⁴, shtetasja E.B (nëna e subjektit) ka deklaruar: “Në vitin 2009 i kam dhuruar vajzës time shumën prej 500,000 lekësh. Këto para i kam siguruar nga biznesi im privat bar-kafe në fshatin K, Lushnjë, aktivitet të cilin e kam filluar në vitin 1996 dhe deri aktualisht. ...Kjo shumë nuk është dorëzuar me kontratë dhurimi më parë për shkak të marrëdhënieve familjare”.

²³ Shkresë nr. *** prot., datë 2.3.2021, e Credins Invest.

²⁴ Aneks nr. 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së.

5.3 Në analizë të burimit të ligjshëm të të ardhurave të nënës së subjektit rezultoi e provuar²⁵ se shtetasja E.B figuron e regjistruar si person fizik me NIPT *** në datën 1.1.2003, me objekt veprimtarie “Bufe”. Drejtoria e Taksave të Pushtetit Vendor K-Lushnjë²⁶ ka konfirmuar qarkullimin e vetëdeklaruar (të parashikuar) për periudhën 2007 – 2013, për të cilin janë shlyer detyrimet tatimore sipas legjislacionit të kohës. Komisioni hartoi analizën financiare për të hetuar mundësinë e nënës për të krijuar gjendjen *cash* të cilën ia ka dhuruar subjektit, duke llogaritur të ardhurat neto për periudhën 2007 – 2013, me marzh fitimi 40% të qarkullimit të deklaruar referuar praktikës së Komisionit. Nga analiza e kryer rezulton se nëna e subjektit ka pasur mundësi të kursejë dhe t’i dhurojë vajzës së saj vlerën 500,000 lekë.

5.4 *Lidhur me burimin e krijimit të gjendjes cash të deklaruar në DIPFP-në e vitit 2009*

5.4.1 Në DIPFP-në e vitit 2009, subjekti deklaroi kursime *cash* me të ardhura nga paga pranë Bashkisë Fier dhe bursa në Shkollën e Magjistraturës, në vlerën 1,300,000 lekë.

5.4.2 Nga analiza financiare për periudhën 1.8.2005 – 1.10.2009 rezultoi se subjekti ka pasur mundësi burimesh të ligjshme për të krijuar gjendjen financiare të kursimeve *cash* prej 1,300,000 lekësh në vlerën 106,684 lekë.

5.5 *Lidhur me burimin e krijimit të gjendjes cash të deklaruar për vitin 2014*

5.5.1 Subjekti, në procesverbalin e ILDKPKI-së të mbajtur në datën 21.1.2016, mbi gjendjet *cash* gjatë viteve, deklaroi: “Për deklarimin para fillimit të detyrës – Gjendja *cash* në momentin e deklarimit ka qenë në total 1,800,000 lekë dhe burimi ka qenë ai (sipas deklarimit)...”. Ndërsa për gjendjen e kursimeve *cash* në banesë në datën 31.12.2014, ka deklaruar: “Gjendja *cash* që unë disponoj (më 31.12.2014) është 4,180,000 lekë”.

5.5.2 Komisioni, me pyetësin nr. 2, i kërkoi subjektit sqarime në lidhje me gjendjen *cash* të kursimeve në fund të çdo viti deklarues, për të cilat shpjegon si vijon: “Gjendja *cash* në vlerën 4,180,000 lekë, deklaruar më 31.12.2014, është krijuar nga të ardhurat e realizuara ndër vite nga unë dhe bashkëshorti im E.Z... Më konkretisht, të ardhurat e realizuara prej meje, nga të cilat kam mundur të krijoj kursime në vlerën 1,800,000 lekë, janë: nga bursa e Shkollës së Magjistraturës kam realizuar të ardhura në vlerën 1,013,115 lekë; nga punësimi në Bashkinë Fier kam realizuar të ardhura në vlerën 737,876 lekë... Ndërkohë, kursimet nga të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti im E.Z janë krijuar: nga puna si oficer i policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit në vitet 2002 – 2007, përkatësisht në shumën 2,835,767 lekë nga paga dhe 248,126 nga shpërblime dhe dieta, 2007 – 2009 reformë, gjatë së cilës ka përfituar pagesë kalimtare, nga e cila ka kursyer shumën 780,000 lekë, si dhe të ardhura të realizuara nga emigracioni ekonomik po në vitin 2007 – 2009 në shtetin anglez... Nga të gjitha të ardhurat e realizuara, bashkëshorti në momentin e deklarimit për herë të parë, DPV 2011, ka deklaruar kursime *cash*, përkatësisht 2,000,000 lekë dhe 780,000 lekë, si dhe investimin në blerjen e pasurisë së luajtshme automjet në shumën 750,000 lekë”.

5.5.3 Komisioni informohet nga komunikimi me bankat e nivelit të dytë se të ardhurat e bashkëshortit të subjektit për periudhën 2007 – 2009 janë transferuar në llogarinë e tij pranë Raiffeisen Bank, ku gjendja e kësaj llogarie në tetor të vitit 2009 ka qenë 787,578 lekë, ndërsa deri në dhjetor të vitit 2009 vlera e tërhequr prej tij është në total 310,000 lekë. Pjesa e mbetur prej 476,803 lekësh ka qenë gjendje në llogarinë e bashkëshortit në Raiffeisen Bank deri në vitin 2010. Në analizën e Komisionit është përfshirë si kursim *cash* vetëm vlera 310,000 lekë, me burim nga pagesa kalimtare e bashkëshortit më 31.12.2009.

5.5.4 Ndërsa në lidhje me të ardhurat nga emigracioni, subjekti deklaroi në deklaratën *Vetting* të ardhura nga emigracioni në vlerën 27,000 GBP, por nuk përcillet dokumentacioni provues për të provuar deklarimin e tij. Ndërsa me pyetësin nr. 3 sqaron: “Në deklaratën e interesave private periodike vjetore të vitit 2011, bashkëshorti, në cilësinë e personit të lidhur, ka

²⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 3.3.2021, e DPT-së.

²⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 26.6.2023, e Bashkisë Lushnjë.

deklaruar për herë të parë në rubrikën “Deklarimi i interesave private pasuritë e paluajtshme pasuritë e luajtshme”, në të cilën kërkohet të përshkruash hollësisht “[...] shtesën të çdolloj pasurie të paluajtshme dhe të luajtshme, likuidimeve të regjistruara ose jo në regjistrat publikë”, “Të ardhura të realizuara nga emigracioni. Vlera: 2,000,000 lekë” dhe “Të ardhura të realizuara nga dalja në reformë policore për periudhën gusht 2007 – korrik 2009. Vlera: 780,000 lekë”, të holla të cilat i përkasin vlerës së të ardhurave të disponuara cash në datën e deklaramit për herë të parë nga bashkëshorti”.

5.5.5 Në analizën financiare të Komisionit nuk u përfshi vlera prej 2,000,000 lekësh si kursim cash e deklaruar në DIPP-në e vitit 2011 nga bashkëshorti i subjektit, pasi nuk u arrit të provohej burimi i ligjshëm i krijimit të saj, duke përfshirë krijimin e pamundësisë financiare në vitin 2014, kur deklaroi se gjendja e kursimeve cash është në shumën 4,180,000 lekë.

5.5.6 Ndërsa gjendjet e kursimeve cash të përfshira në analizën e Komisionit paraqiten në tabelën si më poshtë²⁷:

DIPP	2009	2010	2011-2012	2013	2014	2015	2016	Vetting
Gjendja e kursimeve cash në lekë	1,900,000	1,900,000	4,680,000	4,280,000	4,180,000	4,249,085	3,449,085	1,300,000
Depozita e kursimit në C* bank								1,263,025
Mospërputhja e vlerës së gjendjes së kursimeve cash në deklaratën vetting me DIPP 2016							886,060	

5.6 Komisioni, gjatë hetimit të kësaj pasurie, ka konstatuar se:

- Subjekti i rivlerësimit ka pasur pamundësi në krijimin e gjendjes së kursimeve cash para fillimit të detyrës prej 1,300,000 lekësh, në vlerën negative prej 106,684 lekësh.
- Subjekti dhe bashkëshorti kanë pamundësi në vlerën 1,520,551 lekë në krijimin e gjendjes së kursimeve cash të deklaruar për vitin 2014.
- Rezultoi mospërputhje në shumën 886,060 lekë të gjendjes së kursimeve cash në fund të vitit 2016 me gjendjen e kursimeve cash të deklaruar në deklaratën *Vetting*.

Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

5.7 Subjekti i rivlerësimit, gjatë seancës dëgjimore, por edhe në prapësime, shpjegon se përpara se të lidhte martesën ligjore ka pasur një ekonomi të përbashkët me prindërit, nga e cila një pjesë të shpenzimeve ia kanë përballuar ata, duke mundësuar të kursente më shumë nga të ardhurat nga paga. Subjekti shpjegon se analiza financiare për krijimin e kursimeve cash përpara marrjes së detyrës duhet të përfshijë edhe prindërit dhe se nga ajo rezulton se ata kanë pasur mundësi²⁸ të kursejnë vlerën totale prej 1,800,000 lekësh të kursimeve cash.

5.8 Në lidhje me gjendjet cash, shpjegon se në vitin 2010 ka deklaruar se ka tërhequr nga Raiffeisen Bank të gjitha likuiditetet përgjatë vitit 2010, të cilat janë mbajtur gjendje cash në banesë. Ky fakt provohet nga *statement*-i i llogarisë pranë Raiffeisen Bank, nga e cila rezulton se tërheqjet në këtë bankë janë kryer në fund të vitit 2009, edhe pse nuk ka deklaruar shtesë në gjendjen cash në DIPP-në e vitit 2009. Pra, subjekti ka tërhequr deri në datën 31.12.2009 vlerën

²⁷ Gjithashtu, në tabelë është përfshirë edhe depozita e kursimit pranë Credins Bank sh.a., e hapur në janar të vitit 2016, përpara plotësimit të deklaratës *Vetting* dhe me burim krijimi gjendjen e kursimeve cash në dhjetor të vitit 2016 (e cila trajtohet në vijim).

²⁸ Rezultati financiar i analizës së prindërve të kryer nga Komisioni për periudhën 2007 – 30.9.2009 është 591,268 lekë.

totale 100,000 lekë. Gjendja e kursimeve *cash* në datën 31.12.2009 është 1,900,000 lekë.

5.9 Subjekti i rivlerësimit shpjegon se në vitin 2011 ka lidhur martesë ligjore me bashkëshortin E.Z dhe në DIPP-në e vitit 2011 ky i fundit deklaroi të ardhura në shumën 780,000 lekë të realizuara nga dalja në reformë policore për periudhën gusht 2007 – korrik 2009. Këto të ardhura janë deklaruar në rubrikën “Deklarimi i interesave privatë-pasuritë e paluajtshme-pasuritë e luajtshme” dhe përfaqësojnë gjendjen *cash* të shtuar me pasurinë e bashkëshortit në fund të vitit 2011 pas lidhjes së martesës ligjore.

5.10 Gjatë prapësimeve dhe në seancën dëgjimore, subjekti sqaron se si kontribut për krijimin e gjendjes *cash* të kursimeve të deklaruara nga bashkëshorti në DIPP-në e vitit 2011 kanë shërbyer edhe të ardhurat e tjera nga punësimi i bashkëshortit nga momenti i kthimit nga emigracioni deri në momentin e lidhjes së martesës ligjore, pra për periudhën nëntor 2009 (pas kthimit nga emigracioni) deri në qershor të vitit 2011. Për këtë periudhë në analizën e kryer nga subjekti rezultoi se mundësia e kursimit e bashkëshortit ka qenë në shumën 1,384,210 lekë.

5.11 Subjekti ka përcjellë me prapësime shpjegime për deklarimet e gjendjes *cash* në DIPP-në e viteve 2015 – 2016, ku sqaron se ka qenë pasaktësi nga ana e bashkëshortit të deklaronte si pakësim vetëm gjendjen *cash* në shumën 800,000 lekë në DIPP-në e vitit 2015, pasi qëllimi i deklarimit ka qenë të deklarojë pakësim të gjendjes totale të parave, si në bankë ashtu edhe në *cash*, në vlerë totale 800,000 lekë. Gjithashtu, subjekti shpjegon edhe për deklarimin e bashkëshortit në DIPP-në e vitit 2016, se ai nuk ka qenë i qartë në mënyrën e të shprehurit për të identifikuar shumat e kursimeve *cash* që janë pakësuar dhe vlerën e kursimeve në bankë që janë shtuar gjatë vitit 2016.

5.12 Për të ardhurat e bashkëshortit nga emigracioni sqaron se ai ka përfituar të ardhura, një pjesë e të cilave janë materializuar në blerjen e automjetit dhe pjesa tjetër është mbajtur *cash* nga bashkëshorti. Të ardhurat nga emigrimi janë krijuar përpara se subjekti të njëjti me bashkëshortin, të lidhnin martesë ligjore dhe përpara se të emërohej prokurore.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

5.13 Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit për analizën financiare përpara marrjes së detyrës janë shteruese dhe se duke qenë në një ekonomi të përbashkët me prindërit ata kanë pasur mundësi të kursejnë gjendjen *cash*, në total 1,800,000 lekë.

5.14 Gjithashtu vlerëson se shpjegimet në lidhje me gjendjen e kursimeve *cash* në datën 31.12.2009, të dhëna nga subjekti, janë të provuara nga *statement*-i i llogarisë së saj pranë Raiffeisen Bank dhe, si e tillë, gjendja e kursimeve *cash* në këtë datë do të përditësohet në vlerën 1,900,000 lekë, duke rezultuar në pasaktësi të deklarimit të subjektit në DIPP-në e vitit 2009.

5.15 Komisioni, në vijim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti gjatë seancës dëgjimore dhe me prapësime, vlerësoi të përfshijë në analizën financiare si burim të gjendjes *cash* shumën 780,000 lekë nga të ardhurat e bashkëshortit nga paga, e cila konfirmohet nga *statement*-i i Raiffeisen Bank se janë transferuar në llogarinë e tij dhe janë tërhequr të gjitha gjatë viteve 2009 – 2010, pra përpara se të lidhej martesë ligjore.

5.16 Ndërsa në lidhje me pasaktësitë e shpjeguara nga subjekti për deklarimet e bashkëshortit në DIPP-në e viteve 2015 – 2016 për gjendjen e kursimeve *cash* dhe përfshirjen si burim të krijimit edhe të ardhurat e periudhës pas kthimit nga emigracioni deri në lidhjen e martesës ligjore (2010 – 2011), trupi gjykues vlerëson se deklarimet e bëra në deklaratat periodike mbartin elementin e provueshmërisë së kohës. Pra, shpjegimet e subjektit të dhëna gjatë procesit të rivlerësimit janë në funksion të rezultateve të hetimit, duke zhvlerësuar origjinalitetin e deklarimeve periodike dhe vërtetësinë e tij të zhveshur nga ndikimi i procesit të rivlerësimit.

5.17 Në lidhje me gjendjen e kursimeve *cash* në vlerën 2,000,000 lekë të bashkëshortit, me burim të ardhurat nga emigracioni, rezultoi e provuar nga hetimi i hyrje-daljeve në sistemin TIMS dhe nga dokumentacioni i përcjellë me prapësime nga subjekti se ai ka qenë emigrant

deri në nëntor të vitit 2009, pra përpara se subjekti të merrte detyrën dhe të lidhte martesë me të. Kjo përputhet edhe me deklaratimet e bëra nga subjekti për këtë pasuri si në vitin 2011, ashtu edhe në deklaratën *Vetting*.

5.18 Gjithashtu, rezulton e provuar se subjekti nuk ka paraqitur prova që të vërtetojnë se këto të ardhura të deklaruara janë të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016. Subjekti shpjegon edhe në prapësime se bashkëshorti ka qenë emigrant ilegal gjatë qëndrimit në shtetin anglez.

5.19 Komisioni vlerëson se një situatë e tillë, ku një pjesë e burimeve të të ardhurave *cash* vjen nga një veprimtari e kryer nga ana e bashkëshortit të subjektit para lidhjes së martesës ligjore me subjektin, pra deri në vitin 2009, si dhe kur subjekti nuk ishte emëruar ende prokurore, çon në një vlerësim proporcional të konkluzionit të ligjshmërisë së burimeve të këtyre likuiditeteve. Këto likuiditete nuk mund të sjellin pasoja në drejtim të procesit të vlerësimit të subjektit.

5.20 Në përfundim, Komisioni vlerëson se deklarimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me gjendjen *cash* në vite dhe në deklaratën *Vetting* është i saktë dhe nuk paraqet problematika në lidhje me procesin e rivlerësimit.

6. Vlera monetare e depozituar pranë Credins Bank, në depozitën në euro, me nr. llogarie ***, të kursyera nga të ardhurat e realizuara nga puna në Bashkinë Fier dhe bursa e Shkollës së Magjistraturës. Vlera: 9,500 euro. Pjesa takuese: 100%.

Fakte nga hetimi administrativ kryesisht

6.1 Subjekti ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2017 për herë të parë depozitim të kësaj shume në llogarinë në euro pranë Credins Bank: “...më 27.1.2017 kam depozituar shumën 9,500 euro. Këtë shumë e kam pasur në lekë, e krijuar nga kursimet ndër vite dhe e konvertuar në euro...”.

6.2 Credins Bank ka konfirmuar²⁹ depozitën në emër të subjektit në shumën 9,500 euro, e cila është krijuar nga depozitimi i kësaj shume në datën 27.1.2017, me përshkrimin “Derdhje *cash*, arkëton Rovena Zoto, kursime nga puna”. Vlera e mësipërme është investuar në depozitë kursimi dhe vlera 3,507 euro është mbajtur si e tillë deri në datën 31.12.2020, ndërsa diferenca (pra vlera 6,000 euro) është tërhequr *cash* prej saj gjatë vitit 2018.

6.3 Në lidhje me burimin e krijimit të shumës *cash* të depozituar, nga analiza financiare e Komisionit, trajtuar më lart, rezulton se në fund të vitit 2016 gjendja e kursimeve *cash* në total për subjektin dhe bashkëshortin e saj ka qenë 3,449,085 lekë. Referuar deklaratimit të subjektit të rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2017 se burim i derdhjes *cash* në Credins Bank kanë qenë kursimet *cash* të saj, rezulton se nga gjendja e kursimeve *cash* në vitin 2016 shuma prej 9,500 euro ~ 1,263,025 lekë është përdorur për krijimin e depozitës pranë kësaj banke.

6.4 Në përfundim, Komisioni vlerëson se depozita e kursimit pranë Credins Bank është deklaruar saktë nga subjekti i rivlerësimit.

PASURI TË PERSONIT TË LIDHUR BASHKËSHORTIT TË SUBJEKTTIT Z. E.Z

7. Automjet tip “Mercedes-Benz C Class” (Daimler Chrysler), me targë ***, me nr. identifikimi (shasie) ***, të cilin e ka blerë 5,000 euro në datën 24.12.2014, me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., hartuar nga noterja O.D, Dhoma e Noterisë Lushnjë. Blerë me të ardhurat nga puna. Vlera: 5,000 euro.

Fakte nga hetimi administrativ kryesisht

7.1 Blerja e këtij automjeti është deklaruar në DIPP-në e vitit 2014 (në vlerën 5,000 euro).

²⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 11.3.2021.

7.2 Këtë mjet personi i lidhur e ka blerë me kontratë shitblerjeje datë 24.12.2014, në vlerën 5,000 euro, nga shitësi E.L.Ç. Sipas kontratës, çmimi është likuiduar tërësisht para përpilimit të kontratës³⁰.

7.3 Komisioni hetoi nëse ekzistonte ndonjë konflikt interesi i subjektit për shkak të detyrës me shitësin e mjetit dhe nuk rezultoi që subjekti të ketë hetuar kallëzime dhe/ose procedime penale ku ky person të ketë qenë në çfarëdolloj cilësie³¹.

7.4 Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë, bashkëshorti deklaroi se ka përdorur të ardhurat nga puna. Komisioni hartoi analizën financiare për krijimin e pasurisë për periudhën 1.1.2014 – 24.12.2014, nga e cila rezultoi se bashkëshorti kishte mundësi të krijonte pasurinë me të ardhura të ligjshme³².

7.5 Në përfundim, Komisioni vlerëson se: (i) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin; (ii) personi i lidhur ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie.

8. Trashëgimtar i radhës së parë me 1/3 të pasurisë trashëgimore të trashëgimtarit të parë, rezultuar sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.1.2017, hartuar nga noterja E.S, Dhoma e Noterisë Lushnjë. Sipas certifikatës për vërtetim pronësie, e ndjera ka pasur në bashkëpronësi me babain e tij apartamentin prej 55 m², ndodhur në zonën kadastrale ***, me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, lagjja “***”, Lushnjë. Pjesa takuese: 1/6 (nga dëshmia e trashëgimisë).

Fakte nga hetimi administrativ kryesisht

8.1 Këtë të drejtë që i ka lindur si trashëgimtar i pronares së pasurisë³³ e ka deklaruar për herë të parë në deklaratën *Vetting*.

8.2 Apartamenti është blerë në datën 16.7.2014³⁴, me blerës SH.Z dhe D.B (vjehtëri dhe vjehtëra e subjektit)³⁵, kundrejt vlerës 1,000,000 lekë, e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Është regjistruar në ZVRPP-në Lushnjë në bashkëpronësi të bashkëshortëve SH.Z dhe D.Z, me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***.

8.3 Kjo pasuri, me të dhënat sipas deklarimit më lart, është regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve SH.Z, E.Z dhe O.SH.S, si pasuri e përfituar nga dëshmia e trashëgimisë³⁶.

8.4 Rezulton³⁷ se shtetasi SH.Z ka lidhur kontratë furnizimi me ujë me UK Lushnjë sh.a., kontratë e tipit familjar, në lagjen “***”, Lushnjë, me nr. kontrate ***. Faturimet për këtë kontratë kanë filluar në nëntor të vitit 2016 (referuar informacionit të SMI bashkëlidhur shkresës) dhe kontrata është lidhur në datën 13.10.2006. Gjithashtu, rezulton se shtetasi SH.Z ka lidhur kontratë furnizimi me energji elektrike (nr. ***), kategoria “Familjare”. Kontrata është lidhur më 29.1.2009, kohë në të cilën apartamenti ka qenë ende në pronësi të shitësve të këtij apartamenti (shitja është bërë më vonë).

³⁰ Dokumentacioni i vënë në dispozicion nga DPSHTRR-ja me shkresën nr. *** prot., datë 3.3.2021 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 4.3.2021).

³¹ Shkresë nr. *** prot., datë 26.6.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 29.6.2023) dhe shkresë nr. *** prot., datë 29.6.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 29.6.2023).

³² Rezultati financiar 415,475 lekë.

³³ Në datën 23.1.2017 është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore të së ndjerës D.B, e cila ka ndërruar jetë në datën 18.10.2016, duke u përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë shtetasit SH.Z (vjehtëri i subjektit), E.Z (bashkëshorti i subjektit) dhe O.SH.S (Z) (kunata e subjektit).

³⁴ Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.7.2014, notere SH.S (aneks nr. 4/10 në dosjete ILDKPKI-së).

³⁵ Shitës V, DH dhe M.Z.

³⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 13.4.2021, e ASHK-së (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 16.4.2021).

³⁷ Nga shkresa e UK Lushnjë sh.a. me nr. *** prot., datë 2.6.2023 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 5.6.2023).

8.5 Subjekti ka sqaruar se që prej dhjetorit të vitit 2016 e deri aktualisht në këtë apartament jeton vjehri i saj, z. SH.Z.

8.6 Subjekti është pyetur në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë gjatë procesit të rivlerësimit³⁸, për të cilin shpjegon se vlera e shitjes së apartamentit të mëparshëm e prindërve të bashkëshortit, trajtuar më lart, që është shitur në vitin 2011 te shtetasi I.S, ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit të ri.

8.7 Gjithashtu, rezulton se në llogarinë bankare të shtetasit SH.Z pranë BKT-së³⁹ në datën 11.8.2010 është transferuar shuma 1,000,000 lekë, me përshkrimin “I.S për SH.Z-për blerje shtëpie” dhe në datën 21.1.2011 transferohet vlera 4,000,000 lekë, me përshkrimin “I.S për SH.Z-për blerje shtëpie”. Nga totali i vlerës së transferuar prej 5,000,000 lekësh shtetasit SH.Z, subjekti shpjegon me pyetësin nr. 2 se kjo vlerë është mbajtur si depozitë kursimi dhe në datën 16.7.2014 është tërhequr pjesërisht vlera e saj (shuma 1,600,000 lekë ~ 11,420 euro) me të cilën është kryer pagesa e apartamentit nga shtetasi SH.Z.

8.8 Në përfundim, Komisioni vlerëson se: (i) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin; (ii) prindërit e personit të lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie.

9. Ndërtesë në fshatin A – nga shkresa nr. *** prot., datë 24.1.2017, e Drejtorisë së ALUIZNI-t Lushnjë rezulton se babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, ka aplikuar për legalizimin e një ndërtese në fshatin A, Njësia Administrative A, K, Lushnjë, sipërfaqja e së cilës nuk është matur ende nga ALUIZNI. Sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.1.2017, hartuar nga noterja E.S, Dhoma e Noterisë Lushnjë, ka rezultuar se është trashëgimtar i radhës së parë me 1/3 të pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësës. Pjesa takuese: 1/6 (nga dëshmia e trashëgimisë).

Fakte nga hetimi administrativ kryesisht

9.1 Këtë pasuri, për efekt të dëshmisë së trashëgimisë, e ka deklaruar për herë të parë në deklaratën *Vetting*. Shtetasi SH.B.Z (vjehri i subjektit), në datën 30.9.2014 ka plotësuar “Deklaratën për përfshirje në procedurat e legalizimit”. Sipas kësaj deklarate, ndërtimi është ngritur në vitin 1996⁴⁰.

9.2 Meqenëse dokumentacioni i vendosur në dispozicion nga ASHK Drejtoria Vendore Lushnjë nuk ka informacion mbi zhvillimin e objektit pas vetëdeklarimit (në aspektin fizik dhe atë juridik), me pyetësin nr. 2 iu kërkua subjektit informacion mbi ndryshimet që ka pësuar objekti pas vetëdeklarimit të shoqëruar me foto të tij, mbi gjendjen juridike aktuale të objektit⁴¹, mbi destinacionin e tij, si dhe të dhënat financiare të ndërtimit të tij.

9.3 Në përgjigje të pyetësit nr. 2 (pyetja nr. 3), subjekti paraqiti shpjegime të shoqëruara me raportin e vlerësimit nga inxhinierja vlerësuese T.J.

9.3.1 Ky objekt i ndodhur në fshatin A, Njësia Administrative K, është 1 kat, ka sipërfaqe ndërtimore 72.8 m² dhe shtrihet mbi sipërfaqen e pasurisë tokë arë me nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, pasuri kjo e regjistruar në bashkëpronësi të trashëgimtarëve të shtetasit A.Z (përfutur në bazë të ligjit nr. 7501, “Për tokën”).

9.3.2 Objekti është ndërtuar përpara vitit 1994, pasi ai shfaqet në pamje të fotografimit të vitit 1994. Objekti përbëhet nga dy hapësira (njëra me sip. 37.8m² dhe tjetra me sip. 35 m²). Gjysma e objektit është ndërtuar në vitin 1992 (sipas deklaratës për përfshirjen në procedurat e legalizimit, shtesa e objektit është ngritur në vitin 1996).

³⁸ Pyetësor nr. 2.

³⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 12.3.2021, e BKT-së.

⁴⁰ Dokumentacioni bashkëlidhur shkresës nr. *** prot., datë 24.1.2017 (aneks nr. 4/11 në dosjen e ILDKPKI-së).

⁴¹ Dokumentacioni i vendosur në dispozicion nga ASHK Drejtoria Vendore Lushnjë përbëhet vetëm nga vetëdeklarimi, certifikata familjare me përbërje SH.Z dhe D.B, si dhe 4 foto të objektit (4 pamjet).

9.3.3 Pasuria ka funksionuar si ambient shërbimi, por aktualisht është jashtë funksionit dhe nuk përdoret për shkak të amortizimit të saj.

9.3.4 Në lidhje me vlerën e investimit për këtë pasuri, subjekti ka sqaruar se prindërit e bashkëshortit nuk kanë mbajtur dokumentacion dhe për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar vjehri i saj SH.Z nuk e mban mend me saktësi këtë vlerë, për këtë arsye i është referuar raportit të vlerësimit, sipas të cilit vlera e investimit është 460,133 lekë.

9.4 Në vijim, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se as ajo dhe as bashkëshorti nuk tërheqin asnjë të drejtë reale në lidhje me këtë pasuri që është totalisht e amortizuar, e cila për më tepër është krijuar gjatë kohës që ata kanë qenë të mitur.

9.5 Gjatë përgjigjeve të këtij pyetësori (pyetjet nr. 3 dhe nr. 5), subjekti ka shpjeguar se *prindërit e bashkëshortit kanë ushtruar biznes përgjatë viteve 1992 deri në fillim të trazirave të muajit mars 1997...* (bashkëlidhur mandatpagesat për pagimin e tarifës së pastrimit nga biznesi i SH.Z) dhe *SH.Z me familjen e tij... në vitin 1993 filluan punën në lokalit të tyre në A...* Pra, ky objekt është përdorur për biznes.

9.6 Me pyetësorin nr. 2 subjektit iu kërkua që të përcjellë në Komision edhe kontratën e furnizimit me ujë dhe energji elektrike për këtë pasuri.

- Në lidhje me furnizimin me ujë, subjekti përcolli përgjigjen e Ujësjetës Kanalizimeve Lushnjë sh.a.⁴², sipas së cilës për këtë objekt “biznes” nuk kanë të dhëna në sistemin e tyre dhe shoqëria nuk disponon të dhëna më të hershme mbi ekzistencën e kontratave para vitit 2006.
- Në lidhje me kontratën e furnizimit me energji elektrike, subjekti përcolli informacionin nga OSHEE-ja, sipas të cilit në emër të shtetasit SH.B.Z ekzistojnë dy kontrata jofamiljare (privat), të cilat figurojnë me debi 38,002.40 lekë dhe 53,557.2 lekë.

9.7 Referuar këtij informacioni dhe atij të përcjellë në Komision nga FSHU-ja, rezulton se të dyja kontratat jofamiljare (privat) vijnë të faturohen. Njëra prej tyre (nr. ***) ka konsum zero, faturohet me vlerë fikse principali + kamata, data e fillimit të furnizimit është 29.9.2010. Kontrata tjetër (***) është lidhur në datën 3.6.2005.

9.8 Në përfundim, Komisioni vlerëson se: (i) kjo pasuri është krijuar para fillimit të detyrës nga subjekti; (ii) nuk rezultuan të dhëna që ajo të ketë kontribuar në krijimin e saj.

10. Vlera monetare të ndodhura në llogarinë nr. *, hapur pranë BKT-së nga personi fizik “E.Z”, me NIPT ***, llogari për aktivitetin privat si avokat. Këto para kanë ardhur nga puna si avokat. Vlera: 414,852 lekë. Pjesa takuese: 100%.**

Fakte nga hetimi administrativ kryesisht

10.1 Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit deklaroi në deklaratat periodike gjendje të llogarive në BKT prej vitit 2012, të cilat kanë burim të ardhurat nga paga e tij. Në deklaratën e vitit 2016 deklaroi gjendjen e llogarisë së biznesit pranë BKT-së nga fitimet e aktivitetit të avokatisë.

10.2 BKT-ja⁴³ konfirmon se shtetasi E.Z ka hapur llogari bankare pranë saj në datën 16.1.2015 dhe në këtë llogari janë kryer pagesa *cash* për shërbimet e avokatisë nga persona të tretë në vlerë totale 646,000 lekë për vitin 2015 dhe në vlerën 677,000 lekë për vitin 2016. Gjendja e llogarisë rrjedhëse në datën e deklarimit ka qenë në shumën 414,852 lekë, e cila përputhet me deklarimin e personit të lidhur.

10.3 DPT⁴⁴ dhe QKB⁴⁵ konfirmojnë se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka realizuar fitim nga aktiviteti i avokatisë i regjistruar me NIPT ***, në datën 7.1.2015, si më poshtë vijon:

⁴² Shkresë nr. *** prot., datë 27.6.2023.

⁴³ *Statement* bankar i përcjellë nga subjekti me pyetësorin nr. 2.

⁴⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 3.3.2021, nga DPT-ja.

⁴⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 2.3.2021, nga QKB-ja.

- gjatë vitit 2015 të ardhura neto në shumën 811,346 lekë;
- gjatë vitit 2016 të ardhura neto në shumën 1,070,932 lekë.

10.4 Nga hetimi rezultoi mospërputhje me deklarinimin e të ardhurave të tij nga ato të përfshira në analizën financiare, pasi bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit deklaroi të ardhurën bruto (qarkullimin) të realizuar, ndërsa në analizën financiare janë përfshirë të ardhurat neto pas zbritjes së detyrimeve tatimore⁴⁶.

10.5 Në përfundim, Komisioni vlerëson se deklarimi i personit të lidhur për llogarinë e tij pranë BKT-së është i saktë, në përputhje me të dhënat e përcjella nga institucioni.

11. Vlera monetare të ndodhura në llogarinë rrjedhëse nr. *, hapur pranë Raiffeisen Bank, si llogari kreditimi page nga Drejtoria e Policisë Fier.** Këto para janë krijuar nga pagesa kalimtare nga reforma si ish-oficer i policisë së shtetit. Vlera: 506,577 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Fakte nga hetimi administrativ kryesisht

11.1 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën⁴⁷ “Nxjerrje llogarie Raiffeisen Bank për E.Z, gjendja e llogarisë në datën 25.1.2017 është 506,577 lekë”. Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit e deklaroi llogarinë e mësipërme në deklaratat periodike duke nisur prej vitit 2011.

11.2 Raiffeisen Bank⁴⁸ informon se bashkëshorti i saj e ka hapur këtë llogari në datën 4.5.2005, e cila është mbyllur më 31.12.2019. Në këtë llogari janë transferuar të ardhurat nga paga, përfshirë edhe pagesat kalimtare deri në dhjetor të vitit 2016. Gjendja e llogarisë në datën e plotësimit të deklaratës së pasurisë ka qenë 506,577.99 lekë, e cila përputhet me deklarinimin e subjektit të rivlerësimit.

11.3 Në lidhje me burimin e krijimit të gjendjes së llogarisë rrjedhëse, bashkëshorti deklaroi pagat si oficer i policisë së shtetit dhe pagesat kalimtare. Komisioni hetoi mbi të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti gjatë periudhës 2011 – 2016, duke përfshirë në analizën financiare të ardhurat e konfirmuara nga ISSH-ja dhe DPT-ja⁴⁹, të transferuara në llogaritë e tij bankare, të cilat janë paraqitur më poshtë:

Viti	Nga korriku 2011	2012	2013	2014	2015	2016
Të ardhurat	367,743 lekë	513,841 lekë	567,127 lekë	787,890 lekë	343,466 lekë	312,290 lekë

11.4 Në përfundim, Komisioni vlerëson se deklarimi i personit të lidhur për llogarinë e tij pranë Raiffeisen Bank është i saktë, në përputhje me të dhënat e përcjella nga institucioni.

GJETJE TË TJERA

12. Pasuritë nr. *, ***, *** dhe nr. *** të llojit ndërtesë, të ndodhura në z. k. ***, të regjistruara në bashkëpronësi të nënës dhe babait të subjektit.** Këto pasuri janë përfituar me kontratë shitjeje me AKP-në në vitin 1999, kur subjekti ishte 16 vjeç.

12.1 Nga informacioni i vendosur në dispozicion nga ASHK-ja⁵⁰ rezultoi se babai i subjektit, z. V.F.B, në datën 10.10.2006, me shkresën nr. *** prot., ka vetëdeklaruar legalizim objekti “Lokal + banesë”, 2 kate mbi tokë, vit ndërtimi 2000, sipërfaqe e zënë 580 m², sipërfaqe ndërtimi 100², ndodhur në K, Lushnjë.

⁴⁶ Totali i të ardhurave të përfshira në analizën financiare është 1,882,278 lekë, ndërsa subjekti i rivlerësimit deklaroi në deklaratën Vetting: “Fitime të realizuara nga puna si avokat me NIPT ***, për periudhën 7.1.2015–31.12.2016, sipas vërtetimit të DRT Fier dhe periudha 1.1.2017 e në vazhdim sipas Faturave Tatimore Shitje, vlera 1,908,944 lekë”.

⁴⁷ Aneks nr. 4/14.

⁴⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 11.3.2021, nga RBAL.

⁴⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 3.3.2021, nga DPT-ja.

⁵⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 13.4.2021 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 16.4.2021).

12.2 Objekti është ndërtuar mbi pasurinë në pronësi të vetëdeklaruesit (shtetasi V.B), të regjistruar me nr. pasurie ***, me sip. 580 m², z. k. ***.

12.3 Objekti është legalizuar nga ALUIZNI/Drejtoria Rajonale Lushnjë, me leje legalizimi nr. ***, datë 27.11.2015 (nr. ***, nr. serial ***), “Godinë e kombinuar 2 kate”. Sipas lejes së legalizimit, sipërfaqja e ndërtimit është 106 m², sipërfaqja e parcelës ndërtimore është 206 m². Sipërfaqe totale e ndërtimit: 161 m² për banim + 106 m² për aktivitet.

12.4 Rezulton se bashkëshorti i subjektit, për efekt të procedurave të legalizimit, ka bërë pranë Credins Bank dy pagesa në favor të ALUIZNI-t⁵¹: një në datën 13.11.2015, në vlerën 8,300 lekë dhe tjetra në datën 15.2.2017, në vlerën 2,660 lekë. I pyetur nga Komisioni mbi arsyen e kryerjes së pagesave nga bashkëshorti i saj për objektin e vetëdeklaruar nga babai i saj, subjekti sqaroi se pagesat janë bërë nga shtetasi E.Z për llogari të shtetasit V.B, për arsye se ky i fundit jetonte në fshatin K, Lushnjë, ndërkohë që subjekti dhe bashkëshorti i saj jetonin në qytetin e Lushnjës, ku duhet të kryeshin pagesat. Pra, pagesat janë kryer nga shtetasi E.Z për t’i ardhur në ndihmë babait të saj.

12.5 Dy pasuritë e mësipërme (trualli dhe objekti) janë regjistruar në bashkëpronësi të prindërve të subjektit, me pasuri nr. ***, z. k. ***, me sipërfaqe totale 580 m², sipërfaqe ndërtese 148 m², pasuri e përfitur nga bashkimi i pasurive.

12.6 Komisioni pyeti subjektin⁵² se çfarë ndryshimesh ka pësuar objekti nga momenti i vetëdeklarimit deri aktualisht. Subjekti deklaroi se gjendja e faktit e objektit 2 kate përputhet me gjendjen e regjistrimit, përveç mbulesës, që rezulton të jetë mbulesë çatie me tjegulla (pjesërisht e shfrytëzueshme si magazinë), e cila është realizuar në vitet 2017 – 2018 për të eliminuar lagështinë e soletës nga ujërat e shiut. Subjekti përcolli në Komision aktin e ekspertimit të përgatitur nga ing. T.J, eksperte e licencuar për vlerësim të pasurive⁵³, në të cilin ajo ka konkluduar se objekti është ndërtuar në një periudhë kohore duke filluar nga viti 2000, vit në të cilin është ndërtuar kati i parë me funksion lokal dhe, më tej, në vitin 2003 – 2004 ka përfunduar edhe kati i dytë me funksion banimi. Në përfundim, ka arritur në konkluzionin se: *“Nga shqyrtimi i gjithë dokumentacionit tekniko-ligjor, si dhe nga inspektimi në vend i pasurisë, rezulton se godina 2 kate, i vetëdeklaruar më 10 tetor të vitit 2006 të jetë i njëjti objekt, i cili është legalizuar me lejen e legalizimit nr. ***, datë 27.11.2015, si dhe me gjendjen aktuale sot”*. Në lidhje me vlerën e investimit, ekspertja ka arritur në konkluzionin se vlera e investimit të këtij objekti llogaritet në total 4,068,584 lekë.

12.7 Mbi këtë pasuri është vendosur hipotekë ligjore në favor të NBG Bank, me kontratë hipotekimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.5.2008⁵⁴. Nga informacioni i përcjellë nga banka⁵⁵ rezulton se prindërit e subjektit kanë marrë kredi bankare me vlerë 25,000 euro për blerje apartamenti me adresë lagjja “****”, Lushnjë, sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.2.2008.

12.8 Në lidhje me apartamentin për të cilin është marrë kredia dhe lidhur kontrata e shitblerjes si më lart, subjekti sqaroi: *“Pas konsultës me nënën time E.B jam vënë në dijeni të faktit se kontrata nr. ***rep., nr. *** kol., datë 25.2.2008, për blerje apartamenti me adresë lagjja “****”, Lushnjë nuk është finalizuar asnjëherë. Pra, i ndjeri babai im nuk ka qenë asnjëherë pronar i kësaj pasurie”*. Në vijim sqaroi se pas kryerjes së verifikimeve në ASHK ka rezultuar se kjo pasuri me nr. ***, e ndodhur në z. k. ***, me sip. 108.67 m², me adresë lagjja “****”, Lushnjë, e llojit apartament, i është shitur personave të tjerë⁵⁶. Gjithashtu, ka deklaruar se: *“Nuk*

⁵¹ Shihni mandatarkëtimet, pjesë e praktikës së vënë në dispozicion nga ASHK-ja.

⁵² Pyetësor nr. 2, pyetja 1.

⁵³ Licencë nr. regj. vp. ***.

⁵⁴ Informacion i dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 13.4.2021, nga ASHK-ja (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 16.4.2021).

⁵⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 3.3.2021, nga ABI Bank.

⁵⁶ I është shitur me kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.1.2020, shtetases G.M, me palë shitëse: A.K, H.N, A.K, A.LL dhe A.LL.

rezulton në asnjë moment që kjo pasuri të jetë blerë nga i ndjeri babai im V.B. Për rrjedhojë, nuk ekziston dokumentacion për blerjen e këtij apartamenti nga babai im...”.

12.9 Në shpjegimet e saj subjekti ka referuar një deklaratë noteriale⁵⁷ të bërë nga ish-bashkëpronarët e kësaj pasurie në kohën kur është lidhur kontrata, të cilët kanë deklaruar se në lidhje me apartamentin me nr. pasurie ***, z. k.***: “... në datën 25.2.2008 është nënshkruar një kontratë premtim shitjeje ndërmjet nesh dhe shtetasit V.B, me kusht financimin e blerjes nga një kredi bankare. Ky kusht nuk është realizuar dhe ne kemi dakordësuar verbalisht me të ndjerin V.B për prishjen e kësaj kontrate. Ne nuk kemi lidhur kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme me shtetasin V.B për arsye të mosplotësimit të kushtit dhe jemi rikthyer në gjendjen fillestare pa pasur më asnjë pretendim ndaj njëri-tjetrit edhe për shkak të njohjeve personale që kemi pasur me njëri-tjetrin”.

12.10 Nga kontrata e kredisë së mësipërme, vendosur në dispozicion nga ABI Bank⁵⁸, rezulton se kredia është disbursuar në datën 13.5.2008 në favor të znj. E.B, ndërsa nga komunikimi me ABI Bank⁵⁹ rezulton se përfituesi i vlerës 24,491 euro, e transferuar nga llogaria e znj. E.B është shoqëria “LL” sh.p.k., me NIPT ***.

12.11 Me përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti përcolli dy kontratat e sipërpërmendura: (i) kontratën e premtim shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.2.2008 (që sipas shpjegimeve të saj nuk u finalizua asnjëherë në kontratë shitjeje dhe babai i saj nuk u bë asnjëherë pronar i apartamentit objekt i kësaj kontrate) lidhur midis babait të subjektit dhe shoqërisë “LL” sh.p.k., për të cilën është marrë kredia bankare; (ii) kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.1.2020, që, sipas shpjegimeve të subjektit, është kontrata me të cilën apartamenti për të cilin ishte lidhur më parë kontrata e sipërpërmendur e premtimshitjes i është shitur më pas nga (ish) bashkëpronarët shtetases G.M.

12.12 Nga këto kontrata rezultoi se kontrata e premtimshitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.2.2008 (për të cilën është marrë kredia) është lidhur për një apartament të ndodhur në objektin e ndërtuar nga shoqëria “LL” sh.p.k. me lejen e ndërtimit nr. ***, datë 16.1.2007. Kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.1.2020, me blerës znj. G.M (e cila nuk u vendos në dispozicion e plotë nga ana e subjektit) është lidhur për apartamentin e ndërtuar me lejen e ndërtimit nr. ***, datë 18.11.2008. Komisioni i kërkoi subjektit sqarime në lidhje me sa rezultoi si më lart⁶⁰, si dhe për mënyrën e përdorimit të vlerës së përfituar me kredi⁶¹.

12.13 Subjekti sqaroi se pas këtij konstatimi, me qëllim sqarimin e situatës, i është drejtuar noteres pranë së cilës janë përpiluar kontratat, si dhe ASHK-së nga e cila kishte tërhequr kontrata nr. ***, datë 17.1.2020, dhe ka rezultuar se: “Tek kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.1.2020, me blerës G.M, është bërë lapsus tek pjesa ku thuhet “bashkëngjitur”, pasi aty citohet një leje e ndryshme nga e sakta (f. 3 e kontratës). Por në paragrafin “Origjina e pronës” (faqe nr. 2 e kontratës, me titull “Objekti”) pasqyrohen saktë si leja e sheshit të ndërtimit edhe ajo e ndërtimit, të cilat janë: “Leje sheshi nr. ***, datë 5.12.2006” dhe “Leje ndërtimi nr. ***, datë 16.1.2007” (të cilat përputhen/janë të njëjta me ato të pasqyruara te kontrata premtim shitje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.2.2008)⁶². Të njëjtin lapsus noterja e ka bërë edhe te një kontratë tjetër shitjeje po tek i njëjti objekt⁶³...”. Në vijim sqaron se ka tërhequr pranë ASHK-së Lushnjë praktikat e dy lejeve të ndërtimit si më

⁵⁷ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.6.2023, notere O.D.

⁵⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.2.2021 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 3.3.2021).

⁵⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 13.7.2023, nga ABI Bank.

⁶⁰ Pyetësor nr. 4

⁶¹ Pyetësor nr. 4.

⁶² Për të mbështetur këtë sqarim ka depozituar në Komision një vërtetim datë 21.7.2023 të lëshuar nga noterja pranë së cilës janë lidhur kontratat (O.D), në të cilin ajo sqaron dhe vërteton lapsusin e sqaruar dhe nga subjekti.

⁶³ Bashkëlidhur ka vendosur në dispozicion kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.7.2020, lidhur tek po e njëjta notere (O.D), lidhur për një apartament në të njëjtin objekt si më lart, në të cilën në zërin “Objekti” ka referuar leje sheshi nr. ***, datë 5.12.2006, leje ndërtimi nr. ***, datë 16.1.2007, ndërsa në pjesën “Dorëzimi i pasurisë” ka referuar leje ndërtimi nr. ***, datë 18.11.2008.

lart, nga të cilat rezulton se të dyja objektet janë në të njëjtën adresë në qytetin e Lushnjës, por tek objekti me leje ndërtimi nr. ***, datë 16.1.2007, njëri prej investitorëve është edhe z. H.N, i cili ka qenë dhe në cilësinë e njërit prej shitësve tek kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.1.2020 me blerës znj. G.M. Ndërkohë që tek objekti me leje sheshi nr. ***, datë 31.10.2008 dhe leje ndërtimit nr. ***, datë 18.11.2008, z. H.N nuk është investitor⁶⁴.

12.14 Në lidhje me mënyrën e përdorimit të vlerës së përfituar me kredi, subjekti sqaroi se pasi është konsultuar me nënën, ka mësuar se një pjesë e kësaj kredie është përdorur për ndërtimin e një njësie banimi 1 kat, me sip. 42 m², ndërtuar në pasurinë nr. ***, z. k. ***, me sipërfaqe trualli 364 m², në pronësi të prindërve, e cila (kjo e fundit) në vitin 2017 me kërkesë të prindërve u bashkua me pasurinë tjetër të tyre me nr. ***, z. k. ***, duke krijuar pasurinë me nr. ***, z. k. ***, me sipërfaqe totale trualli 580 m² dhe sipërfaqe ndërtese 148 m² (pasuria e trajtuar më lart)⁶⁵, ndërsa pjesa tjetër (të cilën sipas sqarimeve, nëna e subjektit nuk e mban mend saktësisht) është përdorur prej prindërve për shpenzime të zakonshme. Gjithashtu, ka sqaruar se pavarësisht se leja e ndërtimit ka qenë për objekt 2 kate, në fakt është ndërtuar vetëm një kat dhe se prej kohësh, një pjesë e këtij objekti përdoret nga nusja e vëllait të saj si klinikë dentare, ndërsa pjesa tjetër përdoret si magazinë e përgjithshme⁶⁶.

12.15 Rezulton se leja e sheshit të ndërtimit për objektin “Lokal shërbimi 2 kate”, me sipërfaqe ndërtimi 42 m², për të cilin subjekti deklaroi se është përdorur një pjesë e kredisë, është miratuar në datën 29.9.2008 (para se subjekti të fillonte detyrën), ndërsa leja e ndërtimit është miratuar në datën 19.11.2010 (gjatë kohës që subjekti ushtronte detyrën), me afat ndërtimi deri më 9.11.2011 (subjekti është martuar më 10.6.2011). Në përgjigje të pyetësorit standard (pyetja nr. 3), subjekti ka deklaruar se prej datës 12.10.2009, që përkon me datën e fillimit të detyrës deri në datën 10.6.2011, ka jetuar në familjen e origjinës me prindërit dhe me vëllain, e regjistruar në një trung familjar me kryefamiljar V.B. Në përgjigje të pyetjes nr. 1 të pyetësorit standard ka deklaruar se gjatë kësaj periudhe ka bashkëjetuar në mënyrë të ndërthurur midis familjes së origjinës dhe të fejuarit të saj (aktualisht bashkëshorti).

12.16 Ndërsa në lidhje me burimin e krijimit, referuar koston e ndërtimit të EKB-së në zonën e Lushnjës,⁶⁷ për periudhën e ndërtimit (EKB-ja e vitit 2011) të sipërfaqes 42 m², rezulton se vlera e investimit të kryer nga prindërit e subjektit është rreth 1,075,158 lekë.

12.17 Nga sa rezulton më lart, vlera e kredisë prej 24,491 euro ka qenë e mjaftueshme për t’u kryer investimi me vlerë 1,075,158 lekë ~ 7,774 euro nga prindërit e subjektit të rivlerësimit.

12.18 Rezulton⁶⁸ se shtetasi V.B ka lidhur kontratë furnizimi me ujë me UK Lushnjë sh.a., kontratë e tipit familjare, në zonën e K, Lushnjë, me nr. ****. Faturimet për këtë kontratë kanë filluar në maj të vitit 2015 (sipas informacionit të SMI-së bashkëlidhur shkresës).

12.19 Rezulton se në emër të shtetases E.M.B ekziston e lidhur një kontratë furnizimi me energji elektrike me kod ***, kategoria jofamiljare (privat), me adresë K, Lushnjë⁶⁹. Kjo kontratë është lidhur në datën 30.5.2005. Subjekti ka sqaruar se kontrata e furnizimit me energji elektrike për aktivitetin “bar-kafe” është regjistruar në emër të nënës së saj E.B, duke qenë se aktiviteti tregtar ka qenë regjistruar në emër të saj.

⁶⁴ Bashkëlidhur ka dërguar kopje të këtyre dy praktikave.

⁶⁵ Bashkëlidhur pyetësorit nr. 4, ka përcjellë lejen e sheshit të ndërtimit dhe lejen e ndërtimit për “Lokal shërbimi 2 kate”, për z. V.B, si dhe certifikatën e pronësisë për pasurinë nr. ***, të trajtuar më sipër, si dhe certifikatën e pronësisë dhe kartelën e kësaj pasurie.

⁶⁶ Bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 4, subjekti ka përcjellë foto aktuale të objektit, kopje të diplomës së znj. B.B si mjek stomatolog, kopje të licencës “Për ushtrimin individual të profesionit për stomatologji”, certifikatë e regjistrimit të saj pranë organit tatimor për biznesin mjek stomatolog, certifikatën e martesës së saj me vëllain e subjektit, z. E.B, si dhe certifikatë familjare të familjes B.

⁶⁷ Udhëzim nr. 3, datë 3.2.2010, ku vlera e koston e ndërtimit për sipërfaqen e ndërtimit ka qenë 27,599 lekë/m².

⁶⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 2.6.2023, nga UK Lushnjë (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 5.6.2023).

⁶⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 27.6.2023, depozituar në Komision nga subjekti me përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

12.20 Identifikohen dy abonentë me gjeneralitetet V.B, të cilët kanë lidhur kontratë furnizimi në instancën Lushnjë⁷⁰. Të dyja kontratat janë në adresën K, Lushnjë, furnizohen nga nënstacioni A dhe janë lidhur më 28 dhe 30 maj 2005, pra, para fillimit të detyrës së subjektit (respektivisht kontratat nr. *** dhe ***). Njëra nga kontratat (nr. ***) rezulton me status “Bill Stop” dhe tjetra me status “Live”. Komisioni kërkoi nga FSHU-ja informacion më të detajuar për këto kontrata dhe kjo e fundit sqaroi⁷¹ se nuk disponon kopje të kontratave para vitit 2007.

12.21 Në përfundim, Komisioni vlerëson se: (i) objekti bazë është ndërtuar para se subjekti të merrte detyrën; (ii) shtesa e ndërtimit me sip. 42 m² është ndërtuar gjatë kohës që subjekti ushtronte detyrën dhe jetonte me familjen e origjinës; (iii) në analizë të burimit të ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie nuk u identifikuan problematika lidhur me procesin e rivlerësimit, si dhe prindërit e subjektit kishin mundësi financiare për kryerjen e investimit me burime të ligjshme.

13. Automjet tip “Volkswagen”, me targë aktuale *, rezultuar gjatë hetimit⁷² i regjistruar në pronësi të shtetasit E.Z**

13.1 Këtë automjet personi i lidhur i subjektit e ka blerë në datën 1.4.2013, në vlerën 400,000 lekë nga shitësi L.A.Z⁷³ dhe ia ka shitur blerësit SH.R.S në vlerën 3,000 euro, në datën 25.8.2014⁷⁴.

13.2 Komisioni hetoi nëse ekzistonte ndonjë konflikt interesi i subjektit për shkak të detyrës me shitësin dhe me blerësin e automjetit dhe nuk rezultoi që subjekti të ketë hetuar kallëzime dhe/ose procedime penale, ku këta persona të kenë qenë në çfarëdolloj cilësie⁷⁵.

13.3 Në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë rezulton se bashkëshorti i saj ka deklaruar në deklaratën e vitit 2013: “*Pakësim i kursimeve si rezultat i blerjes së një automjeti tip “Volkswagen”. Vlera: 400,000 lekë*”. Duke iu referuar deklaratimeve të subjektit dhe bashkëshortit nga marrja e detyrës deri në deklaratën e vitit 2013 mbi gjendjen *cash*, të cilat janë trajtuar më lart, rezulton se gjendja e kursimeve *cash* në fillim të vitit 2013 ka qenë në total në vlerën 1,900,000 lekë⁷⁶.

13.4 Në përfundim, Komisioni vlerëson se: (i) bashkëshorti dhe subjekti kanë pasur mundësi të blejnë me të ardhura të ligjshme automjetin tip “Volkswagen”, me targë ***, në vlerën 400,000 lekë; (ii) nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë pasuri.

14. Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar automjetin tip “Mercedes-Benz”, pasuri e bashkëshortit, me vlerë 750,000 lekë, ndërsa në DIPP-në e vitit 2014 ka deklaruar shitjen e automjetit tip “Mercedes-Benz” në vlerën 2,000 euro⁷⁷

14.1 Në procesverbalin “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, mbajtur nga ILDKPKI-ja më 31.1.2016, subjekti, lidhur me automjetin tip “Mercedes-Benz”, me nr. shasie ***, me targë ***, ka shpjeguar: “*E ka marrë në përdorim bashkëshorti im E.Z. Për marrjen e*

⁷⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 29.3.2021 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 11.3.2021).

⁷¹ Shkresë nr. *** prot., datë 19.7.2023 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 21.7.2023).

⁷² Shkresë nr. *** prot., datë 3.3.2021 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 4.3.2021).

⁷³ Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. **** kol., datë 1.4.2013, not. I.H.

⁷⁴ Kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.8.2014, not. Sh. GJ.

⁷⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 26.6.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (administruar në Komision me nr. **** prot., datë 29.6.2023) dhe shkresë nr. *** prot., datë 29.6.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 29.6.2023).

⁷⁶ Referojuni DIPFD-së 2009 ku gjendja e kursimeve *cash* ka qenë 1,800,000 lekë dhe DIPP-së 2010 me shtim të gjendjes *cash* prej 100,000 lekësh.

⁷⁷ Bashkëlidhur shpjegimeve ka depozituar: prokurën e posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.11.2009, me të cilën shtetasja E.T si pronare e mjetit (nuk ka dokumentacion pronësie bashkëlidhur) ka emëruar përfaqësues të posaçëm z. E.Z, duke i dhënë të drejta të plota që ta përdorë, t’ia shesë vetes ose çdo personi tjetër makinën time, ta japë në huapërdorje makinën me librezë mjete angleze, me të dhëna..., nr. shasie ***, targë ***. Kontratë (jonoteriale) shitjeje automjeti për pjesë këmbimi dhe skrap, lidhur në datën 31.7.2014 midis shtetasve E.Z dhe B.F.H për këtë mjet që, sipas kësaj kontrate, është i regjistruar në shtetin anglez dhe është në pronësi të z. E.Z.

këtij mjete me targa angleze, bashkëshorti E. ka paguar shumën në 750,000 lekë, duke u bërë dhe pronar i ligjshëm i këtij mjete. Në datën 31.7.2014 për shkak amortizimi ky mjet ka dalë jashtë përdorimit dhe është shitur për skrap me çmim 2,000 euro”.

14.2 Nga AMF-ja (sistemi elektronik) rezulton se për këtë mjet ka polica sigurimi, policë kufitare me afat 11.5.2011 – 10.5.2012, ku pronar është shtetasi E.Z dhe përdorues është ai dhe subjekti Rovena Zoto (para kësaj kohe policat kanë qenë: 14.9.2009 – 28.10.2009, policëmbajtëse E.T; 17.7.2009 – 30.8.2009, policëmbajtës GJ.A). Gjithashtu ka prerë TPL, me afat 18.9.2012 – 18.9.2013, ku pronar dhe përdorues rezulton shtetasi E.Z.

14.3 Nga sistemi TIMS⁷⁸ rezulton se shtetasi E.Z ka hyrë (i vetëm) dy herë në territorin shqiptar nga pika kufitare e Kakavijës, konkretisht në datat 9.3.2012 dhe 19.10.2013. Ky mjet ka hyrë në territorin shqiptar në datën 28.12.2008 nga shteti anglez me linjën e udhëtimit Bari-R. D, me drejtues mjete shtetasin GJ.A.

14.4 Komisioni i kërkoi subjektit⁷⁹ të përcjellë kontratën e blerjes së automjetit, si dhe dokumentacionin provues të nxjerrjes së tij jashtë përdorimit dhe të shumës së përfituar nga shitja e tij për skrap, sikurse ka deklaruar në ILDKPKI.

14.4.1 Në përgjigje, subjekti sqaroi: *“Automjeti në fjalë me targë *** ka qenë automjet i regjistruar në shtetin anglez. Për këtë arsye, sikurse kam shpjeguar edhe më herët pranë ILDKPKI-së ky automjet është blerë nga bashkëshorti im E.Z në shumën 750,000 lekë, jo përpara noterit, por sipas procedurave të shtetit anglez, të cilat kanë parashikim të ndryshëm nga legjislacioni ynë. Konkretisht, nga leja e qarkullimit të automjetit shkëputet pjesa e paracaktuar si formular për shitblerjen e mjetit dhe i dërgohet drejtorisë së transportit anglez me të dhënat e blerësit. Pas kësaj procedure, ky institucion gjeneron një leje qarkullimi të re në emër të blerësit”.*

14.4.2 Bashkëlidhur, subjekti ka përcjellë certifikatën e regjistrimit të automjetit në Mbretërinë e Bashkuar, sipas së cilës përdoruesi i mjetit nga data 5.12.2009 është shtetasi E.Z dhe përdoruesi i mëparshëm ka qenë shtetasja E.T. Rezulton se ky dokument nuk është kontratë shitblerjeje, nuk ka as çmimin, as datën e shitjes dhe as mënyrën e pagesës dhe në të theksohet se: *“Poseduesi i regjistruar nuk është domosdoshmërisht pronari ligjor i tij”⁸⁰.*

Në lidhje me shitjen e këtij automjeti sipas deklarimit të tij dhe shumës së përfituar, subjekti ka sqaruar se disponon vetëm kontratën me shkrim (jo para noterit) të lidhur midis shtetasve E.Z dhe B.H, datë 3.7.2014, sipas së cilës shtetasi E.Z ia ka shitur shtetasit B.H⁸¹ këtë automjet për skrap në vlerën 2,000 euro.

14.5 Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë, Komisioni konstaton se prokura e posaçme ku shtetasja E.T ka emëruar përfaqësues shtetasin E.Z është hartuar në datën 25.11.2009 përpara noterit publik. Pra, rezultoi se ky automjet është marrë në përdorim dhe/ose është blerë përpara martesës së tij me subjektin e rivlerësimit.

14.5.1 Gjithashtu, Komisioni, në kushtet e paqartësisë së datës së saktë të blerjes së automjetit nga bashkëshorti i subjektit, ka konsideruar si kohën e blerjes/marrjes në përdorim të tij datën e lëshimit të prokurës së posaçme. Rezulton se bashkëshorti është kthyer nga emigracioni në territorin shqiptar në datën 23.10.2009, nga i cili ka deklaruar se ka fituar të ardhura 27,000 GBP në deklaratën *Vetting* dhe në DIPP-në e vitit 2011 ka deklaruar 2,000,000 lekë të ardhura nga emigracioni. Për të dyja këto vlera ai nuk përcjell dokumentacion provues, ndërsa të ardhurat nga pagesa kalimtare nga policia e shtetit konstatohen se janë transferuar në llogarinë

⁷⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 22.5.2023 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 23.5.2023).

⁷⁹ Me pyetësorin nr. 2.

⁸⁰ *“The registered keeper, is not necessarily the legal owner”.*

⁸¹ Referuar informacionit të QKB-së, shtetasi B.H është i regjistruar me NIPT***, regjistruar në datën 31.3.2010, me objekt veprimtarie “Import-Eksport dhe tregtim automjeteve të përdorura. ... Tregtim pjesë këmbimi të reja dhe të përdorura dhe servis për automjete. Skrap të metaleve dhe të atyre me ngjyrë. Grumbullim dhe transportim i mbetjeve të skrapit/hekurishteve të metalit”.

e tij pranë Raiffeisen Bank dhe nuk janë tërhequr nga bashkëshorti përpara datës së lëshimit të prokurës së posaçme. Pra, rezulton se si burim për blerjen e automjetit mund të kenë shërbyer të ardhurat nga emigracioni, të cilat nuk janë provuar me dokumentacion. Rezulton se bashkëshorti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e automjetit.

14.6 Në përfundim, Komisioni vlerëson se bashkëshorti e ka blerë këtë automjet përpara lidhjes së martesës ligjore me subjektin e rivlerësimit.

15. Adresat e banimit

15.1 Gjatë hetimit, e pyetur mbi adresat e banimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar ndër të tjera adresa banimi për apartamente me qira si: (a) apartament 1+1 me qira, në rrugën “****” (sipas kontratës së sipërmarrjes adresa është rruga “****”⁸²), Tiranë, kundrejt vlerës 15,000 lekë⁸³, me kontratë qiraje verbale; (b) lagjja “****”, p. “****”, Lushnjë; marrë me qira kundrejt vlerës 10,000 lekë, qiradhënës Z.B.Ç⁸⁴; (c) qershor 2021 e në vijim, rruga “****”, apartament me qira, qiradhënës B.SH.

15.2 Komisioni hetoi nëse ekzistonte ndonjë konflikt interesi i subjektit për shkak të detyrës me qiradhënësit e ambienteve ku ka banuar dhe nuk rezultoi që subjekti të ketë hetuar kallëzime dhe/ose procedime penale ku këta persona të kenë qenë në çfarëdolloj cilësie⁸⁵.

16. Analiza financiare për periudhën tetor 2009 – 2016

16.1 Komisioni, në kryerjen e analizës financiare është bazuar në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, në deklaratën *Vetting*, pyetësorët me përgjigjet e subjektit, si dhe në korrespondencën e Komisionit me institucionet publike dhe jopublike. Kjo metodologji shërben për të vlerësuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të realizuar kursimet, pasuritë e deklaruara dhe për të paguar shpenzimet, si dhe evidentimin e rasteve kur subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme pasuritë e krijuara (pasuri të luajtshme, të paluajtshme dhe likuiditete) dhe shpenzimet e kryera.

16.2 Analiza financiare e subjektit për periudhën e hetuar bazohet në të ardhurat e ligjshme sipas vërtetimeve për të ardhurat nga pagat në vlerë neto, lëshuar nga institucionet publike për subjektin e rivlerësimit⁸⁶, të cilat janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore në zbatim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar në deklaratën *Vetting*: “*Të ardhura nga puna si emigrant pa dokumentacion në shtetin anglez për periudhën shtator 2007 – tetor 2009, ku sipas shkresës së Drejtorisë së Kufirit rezulton se kam dalë nga Shqipëria në datën 30.8.2007 dhe jam kthyer nga Londra në datën 23.10.2009, vlera 27,000 GBP*”. Për këto të ardhura nuk është përcjellë dokumentacion provues dhe, si rrjedhojë, nuk janë përfshirë në analizën e Komisionit pasi nuk arrijnë nivel provueshmërie, por janë vetëm deklarative.

16.3 Shpenzimet e jetesës u bazuan në shpenzimet e përcaktuara në shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së drejtuar Komisionit. Në llogaritjen e shpenzimeve jetike në analizën financiare është përfshirë numri i anëtarëve të familjes për të cilët është bërë trajtimi i shpenzimeve jetike në bazë të deklaratimit të subjektit në pyetësorin standard, por duke u mbështetur edhe në gjendjen familjare sipas certifikatave të gjendjes civile. Pra, prej marrjes së

⁸² Sipas shpjegimit të qiradhënëses në deklaratën e lëshuar prej saj.

⁸³ Subjekti i ka bashkëlidhur pyetësorit nr. 1 deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.6.2021, nga shtetasja M.B, e cila ka deklaruar marrëdhënien e qirasë si më lart, marrëdhënie e cila ka qenë verbale.

⁸⁴ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 1 dhe deklaratën noteriale bashkëlidhur nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.6.2021, noter S. M, Lushnjë, deklarues qiradhënësi Z.Ç.

⁸⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 26.6.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 29.6.2023) dhe shkresë nr. *** prot., datë 29.6.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 29.6.2023).

⁸⁶ Shkresat: nr. *** prot., datë 3.3.2021, nga DPT-ja; nr. *** prot., datë 3.3.2021, nga ISSH-ja; nr. *** prot., datë 31.5.2023. Vërtetimet e institucioneve punëdhënëse të përcjella me deklaratën *Vetting* në aneksin nr. 4/7 dhe nr. 4/16.

detyrës në tetor 2009 deri në nëntor 2010 shpenzimet jetike janë llogaritur si familje me 1 anëtar, ndërsa më pas me 4 anëtarë deri në qershor 2011, ku përfshihen prindërit e subjektit dhe vëllai i saj, ndërsa prej qershorit 2011 kur ka lidhur martesën me shtetasin E.Z deri më 29.7.2011 vetëm me 2 anëtarë. Prej datës 29.7.2011 pas lindjes së vajzës shpenzimet jetike janë llogaritur me 3 anëtarë deri në dhjetor 2016.

16.4 Shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit u analizuan bazuar në të dhënat e sistemit TIMS, si dhe në deklaratimet e subjektit⁸⁷. Për përllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si referencë vendimi nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, i Kolegjit, si dhe deklaratimet e subjektit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit, kur subjekti ka deklaruar udhëtime për qëllime pune, të cilat janë provuar me dokumentacion. Gjithashtu, janë konsideruar vetëm shpenzimet minimale prej 5 euro si shpenzime ditore dhe nuk janë konsideruar shpenzimet e akomodimit për rastet kur subjekti ka deklaruar se është akomoduar tek të afërmit dhe e ka provuar me dokumentacion deklarimin e tij. Në rastet e tjera, kur deklaratimet e subjektit kanë qenë të pambështetura në dokumentacion provues, shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit janë konsideruar mbi bazën e vendimit nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, të Kolegjit. Për udhëtimet ditore vajtje-ardhje brenda ditës janë konsideruar vetëm shpenzimet e udhëtimit dhe 5 euro si shpenzime ditore.

16.5 Shpenzimet për blerje automjetesh⁸⁸ u bazuan në deklaratimet vjetore të subjektit, në pyetësorë, si dhe në dokumentacionin përkatës.

16.6 Gjendje e likuiditeteve⁸⁹ në bankë të subjektit dhe bashkëshortit të saj, në fillim dhe në fund të vitit janë analizuar, bazuar në të dhënat e pasqyrave të lëvizjeve bankare

16.7 Në përfundim, në analizë të provave të administruara, rezultoi se subjekti për periudhën tetor 2009 – 2016, përkatësisht në vitin 2014 ka pamundësi financiare me vlerë 1,520,551 lekë, e cila vjen për shkak të mospërfshirjes në analizën financiare të vlerës 2,000,000 lekë kursime *cash* të bashkëshortit me burim të ardhurat nga emigracioni.

16.8 Me dërgimin e rezultateve të hetimit sipas pikës 2 të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e hetimit sa i përket pamundësisë financiare në lidhje me konkluzionet si më lart.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

16.9 Pas dërgimit të rezultateve të hetimit me të cilat iu kalua barra e provës, subjekti depozitoi në Komision prapësime dhe në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 17.11.2023 mbajti të njëjtin qëndrim dhe parashtrori të njëjtat shpjegime me ato të parashtruara në prapësimet e paraqitura me shkrim. Konkretisht, subjekti shpjegoi se është në pamundësi objektive për të provuar të ardhurat nga emigracioni në shtetin anglez të bashkëshortit dhe kërkoi që në burimin e të ardhurave për krijimin e gjendjes *cash* të kursimeve të llogariten edhe të ardhurat nga paga e tij pas kthimit nga emigracioni dhe para martesë, ashtu si dhe të gjithë vlerën 780,000 lekë, e ardhur nga pagesat për Reformën në Polici të marra nga bashkëshorti deri në vitin 2009.

Vlerësimi i Komisionit

16.10 Në analizë të provave të administruara gjatë hetimit, si dhe në konsideratë të jurisprudencës të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit⁹⁰, trupi gjykues çmoi se të ardhurat e deklaruara me burim nga emigracioni i bashkëshortit të subjektit në vlerën 2,000,000 janë të ardhura të cilat janë gjeneruar para se ky i fundit të lidhte martesë me subjektin e rivlerësimit, para se subjekti të jetë emëruar prokuror dhe nuk rezultojnë se janë të ardhura të krijuara nga

⁸⁷Përgjigjet e pyetësorit standard.

⁸⁸ Shihni aneksin nr. 4/8 dhe nr. 4/9, në dosjen e ILDKPKI-së dhe dokumentacionin e dosjes së dërguar nga DPSHTRR-ja shkresa nr. *** prot., datë 3.3.2021 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 4.3.2021).

⁸⁹ Shkresat: nr. *** prot., datë 12.3.2021, nga BKT-ja; nr. *** prot., datë 11.3.2021, nga Raiffeisen Bank; nr. *** prot., datë 24.3.2021, nga Intesa Sanpaolo Bank; nr. *** prot., datë 24.3.2021, nga ABI Bank; nr. *** prot., datë 11.3.2021, nga Credins Bank; nr. *** prot., datë 2.3.2021, nga Credins Invest.

⁹⁰ Shih Vendimin 19/2022(JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

veprimtari të paligjshme, për këtë arsye, këto të ardhura do të konsiderohen të ligjshme. Për pasojë, analiza financiare e subjektit rezulton me një balancë negative në vlerën 82,845 lekë⁹¹.

16.11 Gjithsesi, trupi gjykues kreu rishtazi analizën financiare të subjektit pas dërgimit të parashtrimeve të saj dhe çmoi se edhe sikur të ardhurat e bashkëshortit nga emigracioni të mos konsiderohen si të ardhura të ligjshme, balanca negative rezulton në një vlerë⁹² në shumën totale prej 1,133,396 lekësh.

⁹¹ Kjo vlerë rezulton pasi subjekti shpjegon me prapësime se gjendja *cash* në vitin 2009 është 1,900,000 lekë dhe jo 1,800,000 lekë.

⁹² Rezultatit negativ prej 1,520,551 lekësh i shtohet vlera 82,845 lekë pas shpjegimeve të përcjella nga subjekti me prapësime se gjendja *cash* në vitin 2009 është 1,900,000 lekë dhe jo 1,800,000 lekë. Pra, analiza financiare e subjektit për periudhën tetor 2009 – 2016 është me vlerë negative 1,133,396 lekë.

ANALIZA FINANCIARE TETOR 2009 – 2016

<i>Përshkrimi</i>	tetor 2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	98,999	(509)	3,118,942	571,805	(140,096)	252,094	355,055	(149,137)
Tokë bujqësore në bashkëpronësi, në emër të kryetarit të familjes bujqësore V* B*, e përfutuar si anëtare e familjes bujqësore me ligjin nr. 7501 "Për tokën", fshati K*, L*, me a) arë sip.45 m2 sipasi aktit nr.*** b) Vresht, sip.400 m2; c) arë sip.2650 m2; ç) arë sip.903 m2. B/pronarë në ¼, 25%.								
Në përdorim apartament banimi me sip.121 m2, ndodhur në Lgj. "Xh* N**", Rr. "Sh* K**", L*.								
Të drejtën e përdorimit e kemi marrë nga prindërit e b/shortit, të cilët e kanë porositur apartamentin me kontratë porosie kol, dt.19.11.2014. Vlera 30.250 euro sipas kontratës së porosisë dt.19.11.2014, lidhur midis vjehrrës dhe sipërmarrësit LI* sh.p.k.								
Kam në pronësi automjet tip Mercedes C Class me targa A*, të cilin e kam blerë 5.000 euro me dt.24.12.2014. Blerë me të ardhurat nga puna. Zotëroj 100 %.						700,550		
Sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore, dt.23.1.2017, ka rezultuar se jam trashëgimtar i radhës së parë me 1/3 të pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësës. Sipas Çertifikatës për Vërtetim Pronësie, e ndjera ka pasur në b/pronësi me babain tim apartamentin prej 55 m2 ndodhur në Lagja "S* L**" L*. Zotëroj 1/6 (nga dëshmia trashëgimisë).								
Rezultoni se babai im ka aplikuar për legalizimin e një ndërtese në fshatin A*, Nj* A*, K* L*, sipërfaqja e të cilit nuk është matur ende nga ALUIZNI.								
Sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore dt.23.1.2017, ka rezultuar se jam trashëgimtar i radhës së parë me 1/3 të pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësës. Zotëroj 1/6 (nga dëshmia trashëgimisë)								
Automjet Mercedes Benz C220 CDI me targe B* marre ne perdorim nga bashkeshorti me			750,000					
Automjet tip "Wolkswagen Golf" e regjistruar ne dt. 01.04.2013.					400,000	-400,000		
Shtesa/pakësime likuiditete në bankë dhe CASH	98,999	-509	2,368,942	571,805	-540,096	-48,456	355,055	-149,137
<i>Total likuiditete</i>	<i>1,900,511</i>	<i>1,900,002</i>	<i>4,268,944</i>	<i>4,840,748</i>	<i>4,300,653</i>	<i>4,252,197</i>	<i>4,607,252</i>	<i>4,458,114</i>
DETYRIME	0	(55,524)	(89,204)	0	0	0	304	0
Karte krediti me vlere 300,000 leke e subjektit							304	
Kredi bankare pranë A* Bank sha të marrë prej E* B*.		(55,524)	(89,204)					
PASURI NETO	98,999	55,015	3,208,145	571,805	(140,096)	252,094	354,751	(149,137)
TË ARDHURA të dokumentuara	143,318	1,036,430	5,168,906	1,298,847	1,498,366	1,921,538	2,377,826	2,498,911
Të ardhura nga paga pranë B* F* për periudhën 1.8.2005 – 1.10.2007.								
Të ardhura nga shkolla e magjistraturës prej tetor 2007 e në vazhdim, nga bursa si anëtare e këshillit drejtues të Shkollës së Magjistraturës, si autore shkrimi dhe si lehtësuese.					10,800	4,320	14,745	
Të ardhura nga puna si prokurore stazhi	143,318	805,449						
Të ardhura nga paga si prokurore.		74,381	651,445	687,798	920,439	1,129,328	1,153,269	1,115,689
Të ardhura nga Agjencia e Sigurimeve Shoqërore për leje lindje për periudhën 18.7.2011 – 6.2.2012			318,518	97,208				
Te ardhura te prinderve dhe të vëllait të subjektit për periudhën tetor 2010- qershor 2011		156,600	301,200					
Të ardhura të bashkëshortit para martesë			3,530,000					
Bashkeshorti deklaroi: Të ardhura nga puna si oficer policie pranë Drejtorisë së P* F* dhe të ardhura nga pagesa për punë jashtë orarit, honorarë, veshmbathje, dhe shpërblime nga puna si oficer policie pranë kësaj drejtorie.			367,743	513,841	567,127	787,890	343,466	312,290
Bashkeshorti deklaroi: Fitime të realizuara nga puna si avokat me Nipt L*, për periudhën 7.1.2015 – 31.12.2016.							811,346	1,070,932
Bashkeshorti deklaroi: Te ardhura nga kompania e sigurimeve "S*" si rezultat i demshperblimeve nga siguracioni TPL per demin e automjetit.							55,000	
SHPENZIME	127,165	715,775	1,124,364	538,644	837,070	719,994	853,639	1,215,276
Shpenzime qiraje nga tetor 2009-nentor 2010 (pyetesor standart)	45,000	165,000						
Shpenzime qiraje nga fillimi i bashkejeteses me bashkeshortin			120,000	120,000	120,000	60,000		
Shpenzime për investimin në ndërtimin e sipërfaqes 42 m2 nga prindërit e subjektit		89,597	537,579					
Shpenzime per arredim banese (blerje mobiliesh) DIPP 2016								510,000
Shpenzime per mobilimin e shtepise me qira, deklaruar ne deklaraten e vitit 2010		202,242						
Shpenzime udhëtimi	48,010	54,006	-	-	293,998	-	180,811	-
Shpenzime jetese	34,155	204,930	466,785	418,644	423,072	659,994	672,828	705,276
Analiza dokumentuar	(82,845)	265,640	836,397	188,398	801,392	949,449	1,169,436	1,432,772

Konkluzion përfundimtar për kriterin e pasurisë

17. Komisioni, në përfundim të këtij hetimi administrativ, çmon se në vendimmarrjen e tij përfundimtare, siç konstatohet edhe më lart, duhet të marrë në konsideratë, si vijon:

- i. Subjekti ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e saj dhe të personave të lidhur me të, siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj. Subjekti nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në zotërim ose në përdorim të saj.
- iii. Për sa më sipër, trupi gjykoës vlerëson se subjekti i rivlerësimit Rovena Zoto ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

18. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

19. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar⁹³ raportin nr. *** prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Rovena V. Zoto, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. *** , datë 23.2.2023, të KDZH-së, nga ku rezulton se:

- formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016;
- subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ajo në deklaratën për kontrollin e figurës;
- për të nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

20. Në konkluzion të këtij raporti, AKSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Rovena V. Zoto, por në të është sqaruar se ky raport është përpiluar pa përfshirë përgjigjen e Shërbimit Informativ të Shtetit.

21. AKSIK-ja hartoi me kërkesën e Komisionit përditësim të raportit⁹⁴ në lidhje me subjektin dhe me shkresën nr. *** prot., datë 05.10.2023 përcolli raportin e përditësuar, të deklasifikuar me vendimin nr. *** të KDZH-së, në të cilin konkludohet se: “... në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Rovena V. Zoto, gjykojmë që për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin tuaj nën dritën e informacioneve të tjera që mund të dispononi si pjesë të gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit”.

22. Komisioni i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme dhe SPAK-ut me kërkesën për informacion në lidhje me *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve për përfshirjen e subjektit drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta, që cenojnë figurën e saj.

⁹³ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.2.2023 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 28.2.2023).

⁹⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 7.9.2023.

23. Prokuroria e Përgjithshme ka përcjellë⁹⁵ informacionin e ardhur nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, nga të cilat rezulton se janë regjistruar tri kallëzime penale ndaj subjektit të rivlerësimit, për të cilat është disponuar me vendime për mosfillim të procedimit penal. Këto vendime mosfillimi janë trajtuar te seksioni “Vlerësimi i aftësive profesionale”, në nënçështjen “Të dhënat arkivore lidhur me masa disiplinore, ankesa dhe vlerësime”. Sipas informacionit të përcjellë nga SPAK-u⁹⁶, pas verifikimit të regjistrit të njoftimit të veprave penale të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda nuk rezulton që në emër të subjektit të rivlerësimit Rovena V. Zoto të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

24. Komisioni kërkoi⁹⁷ nga Prokuroria e Përgjithshme përditësim të informacionit në lidhje me subjektin e rivlerësimit, në vijim të informacioneve të dërguara pranë saj nga organet ligjzbatuese. Nga ana e këtij organi nuk ka ende asnjë përgjigje.

25. Në sistemin TIMS u verifikuan personat me të cilët ka udhëtuar subjekti dhe personi i lidhur (bashkëshorti), si dhe pronarët e automjeteve me të cilat ata kanë udhëtuar. Nga kërkimi rezultoi se ata nuk kanë udhëtuar dhe as kanë përdorur mjete të personave të përfshirë në veprimtari kriminale.

26. U konstatua se në vitin 2023, me mjetin e personit të lidhur, z. E.Z, me targë ***, ka udhëtuar 3 herë (hyrje në datën 25.5.2023, dalje në datën 24.2.2023 dhe në datën 1.3.2023) shtetasi A.G.M, i cili nga sistemi TIMS rezultoi se ka qenë i dënuar për veprën penale “Plagosje e lehtë” (2006 – 2007).

27. Komisioni vlerësoi se në kuptim të përcaktimit që neni 3 i ligjit nr. 84/2016 në pikën 15⁹⁸ të tij bën për personat e përfshirë në krimin e organizuar, shtetasi i sipërpërmendur që ka përdorur mjetin e personit të lidhur të subjektit nuk konsiderohet person i përfshirë në krimin e organizuar, për këtë arsye vlerësoi se ky fakt nuk përbën interes për hetimin.

28. Bazuar në informacionet e marra pranë organeve ligjzbatuese janë verifikuar tri çështje penale, nga analizimi i të cilave nuk u konstatuan të dhëna që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit, por vlerësimi i tyre është bërë në raport me indikatorin e integritetit, si një prej treguesve të matshëm në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit (trajtuar në rubrikën “Vlerësimi profesional”/Gjetje të tjera).

29. Trupi gjykues, në kushtet që nga hetimi i kryer: (a) nuk konstatoi mangësi në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës apo vërtetësisë së të dhënave nga subjekti i rivlerësimit; (b) nuk u evidentuan rrethana që mund të përbënin *indicie* për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit apo të mund të cenonin figurën e subjektit sipas dispozitave ligjore të kreut V të ligjit nr. 84/2016; (c) nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës – çmon se subjekti i rivlerësimit, znj. Rovena Zoto, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas

⁹⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 29.6.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 2.9.2021).

⁹⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.2.2021 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 25.2.2021).

⁹⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 14.9.2023.

⁹⁸ “Person i përfshirë në krimin e organizuar” është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10/192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë”.

parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

30. Sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 është përgatitur relacioni për vlerësimin e aftësive profesionale për kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve të tjera ligjore.

31. Prokuroria e Përgjithshme, si organi ndihmës për vlerësimin profesional (para fillimit të ushtrimit të këtij funksioni nga KLP-ja) për procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka hartuar dhe depozituar në Komision me shkresën nr. ***, datë 19.9.2018, raportin profesional për subjektin e rivlerësimit.

32. Ky raport ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

33. Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëvlerësimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe nga arkivi i 23 prokurorive të gjykatave të shkallës së parë.

34. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, znj. Rovena Zoto, tregon korrektësi në zbatimin të ligjit. Në tri aktet procedurale ligjore të paraqitura prej saj dhe në pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, është konstatuar se subjekti ka identifikuar normën ligjore të zbatueshme në të gjitha rastet. Ajo analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e harmonizuar atë me faktin penal apo rrethanat që përcaktojnë masën e dënimit. Subjekti ka respektuar parashikimet ligjore dhe ato nënligjore.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit Rovena Zoto shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Aktet e arsyetuara prej këtij subjekti janë të kuptueshme. Nga pikëpamja gjuhësore respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të aktit të përgatitur prej tij. Aktet e përpiluara nga subjekti i rivlerësimit janë të konceptuara përgjithësisht me tri pjesë. Përmbajtja e akteve u ka dhënë përgjigje çështjeve të parashtruara për zgjidhje. Rezulton se në aktet e përpiluara nga subjekti i rivlerësimit i kushtohet rëndësi pasqyrimit të përmbajtjes së provave, duke paraqitur në mënyrë të hollësishme përmbajtjen e tyre, si dhe tregimit të rrethanave të faktit. Në përmbajtjen e tyre (akteve) formohet lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve të arritura nga prokurori.

Rezulton se konkluzioni i prokurorit, në aspektin arsyetues, lidhur me konstatimin e faktit penal mbështetet në analizimin dhe argumentimin e elementeve të figurës së veprës penale. Në të gjitha aktet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe dosjet e shortuara janë analizuar në mënyrë të hollësishme ose të përmbledhur elementet e veprës penale objekt hetimi.

Prokurorja Rovena Zoto në aktet e analizuara ka përmendur rrethanat e vlerësuara në funksion të masës së dënimit të kërkuar. Për sa më sipër, konstatohet se në aktin e diskutimit përfundimtar janë përmendur disa prej kërkesave për llojin dhe masën e dënimit, të parashikuara nga neni 47 i Kodit Penal, që ka të bëjë me mënyrën e caktimit të tij. Niveli i arsytimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

35. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti rivlerësimi, në periudhën e rivlerësimi ka kryer detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Gjatë periudhës së rivlerësimi prokurorja Rovena Zoto ka trajtuar gjithsej 844 çështje penale⁹⁹. Në referencë të të dhënave statistikore dhe obligimeve të saj ligjore konstatohet se prokurorja ka përballuar ngarkesë pune normale gjatë periudhës së rivlerësimi. Subjekti ka kryer detyrat e saj në pajtim me pikat 2 dhe 2.1 të urdhrin nr. 147, datë 9.5.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në prokuroritë e shkallës së parë”¹⁰⁰. Nga analiza e pesë çështjeve të përzgjedhura në short, qëndrimi i saj është brenda afateve, sipas kërkesave të ligjit procedural penal. Subjekti i rivlerësimi, në respektim të afateve procedurale ka paraqitur qëndrimin e saj para gjykatës dhe nuk është bërë ndonjëherë shkak për shtyrjen e gjyqimeve, për mospërgatitjen e saj për çështjen në gjykim.

Analiza e të dhënave është bërë në referencë të ligjit procedural penal dhe Kushtetutës, të cilat vendosin detyrimin për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Lidhur me efektivitetin në aspektin sasior në raport me kohëzgjatjen e trajtimit të çështjeve dhe kërkesave të ndryshme penale, prokurorja, subjekt rivlerësimi, ka përballuar ngarkesën e punës me efikasitet. Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimi, prokurorja Rovena Zoto, është efikase dhe efektive. Në këtë drejtim duhet evidentuar se koha është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor¹⁰¹.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

⁹⁹ Ngarkesa dhe saktësia e statistikave që ka pasur pasqyrohet në: vërtetimin nr. *** prot., datë 1.2.2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, procesverbalin “Për pasqyrimin e veprimeve të përzgjedhjes së 5 dosjeve për subjektin e rivlerësimi, znj. Rovena Zoto”, datë 1.2.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe tabelat e administruara.

¹⁰⁰ Ky urdhër përcakton se vendimi i mosfillimit të procedimit, vendimi i pushimit të çështjes, kërkesa për caktimin e masës së sigurimit personal, vendimi i zgjatjes së afatit të hetimeve, kërkesa për gjykimin e çështjes, konkluzionet përfundimtare dhe urdhrat në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale formulohen, arsyetohen dhe nënshkruhen nga prokurori i çështjes dhe detyrimin e prokurorit të çështjes për të diskutuar paraprakisht me Drejtuesin e Prokurorisë.

¹⁰¹ Nga dosjet e përzgjedhura me short, trajtuar më lart, rezultojnë:

Dosja nr. 1 – Kallëzimi penal nr. ***, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, data e regjistrimit 5.3.2015, mosfilluar në datën 27.3.2015. Kohëzgjatja e hetimeve 22 ditë;

Dosja nr. 2 – Procedimi penal nr. ***, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, data e regjistrimit 28.10.2015, pushuar në datën 23.12.2015. Kohëzgjatja e hetimeve 1 muaj e 15 ditë;

Dosja nr. 3 – Procedimi penal nr. ***, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, data e regjistrimit 30.9.2013, pushuar në datën 20.11.2013. Kohëzgjatja e hetimeve 1 muaj e 20 ditë;

Dosja nr. 4 – Procedimi penal nr. ***, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, data e regjistrimit 29.1.2015, dërguar për gjykim në datën 16.3.2015. Kohëzgjatja e hetimeve 1 muaj e 17 ditë;

Dosja nr. 5 – Procedimi penal nr. ***, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, data e regjistrimit 21.3.2016, dërguar për gjykim në datën 25.05.2016. Kohëzgjatja e hetimeve 2 muaj e 4 ditë.

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Rovena Zoto, merr pjesë në gjykim si palë, duke përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Konstatohet se tregon profesionalizëm në gjykim dhe në qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, na njohin me faktin penal, me qëndrimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe disponimin e Gjykatës.

36. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurorja Rovena Zoto, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak anësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

37. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara në format letër dhe në tri dokumentet e dorëzuara prej saj, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e Prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Rovena Zoto, rezulton se i është nënshtruar programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës¹⁰².

Hetimi i Komisionit

38. Pavarësisht raportit të dërguar, Komisioni kreu një hetim të pavarur në lidhje me tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti dhe me pesë dosjet e shortuara sipas një shorti objektiv. Pas analizimit të tyre, Komisioni nuk konstatoi problematika, të cilat lidhen me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

39. TË DHËNAT ARKIVORE LIDHUR ME MASA DISIPLINORE, ANKESA DHE VLERËSIMI

39.1 Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme dhe burimeve arkivore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, për subjektin e rivlerësimit, znj. Rovena Zoto, rezulton se:

39.2 Ndaj subjektit të rivlerësimit nuk është marrë ndonjë masë disiplinore¹⁰³.

39.3 Ndaj subjektit të rivlerësimit Rovena Zoto janë regjistruar tri kallëzime penale, për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal¹⁰⁴. Konkretisht:

39.3.1 Kallëzimi penal nr. ***, viti 2017, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, me kallëzuese shtetasen M.T, kundër disa prokurorëve të Prokurorisë së Rrethit Lushnjë, ndër të cilët edhe për subjektin e rivlerësimit. Për këtë kallëzim është marrë vendimi i mosfillimit të procedimit penal datë 15.6.2017. Nuk ka informacion nëse është ankimuar në gjykatë ky vendim mosfillimi.

39.3.2 Kallëzimi penal nr. ***, viti 2019, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, me kallëzues shtetasin E.S¹⁰⁵. Për këtë kallëzim është marrë vendimi i mosfillimit të procedimit penal datë 14.4.2020¹⁰⁶. Nuk ka informacion nëse është ankimuar në gjykatë ky vendim mosfillimi.

39.3.3 Kallëzimi penal nr. ***, datë 8.4.2016, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me kallëzues shtetasin L.K ndaj subjektit të rivlerësimit dhe gjyqtarës E.Ç. Lidhur me këtë kallëzim është vendosur mosfillimi i procedimit penal në datën 5.5.2016. Ndaj vendimit

¹⁰² Në periudhën e rivlerësimit, subjekti është angazhuar në aktivitete profesionale (seminare/trajnime) të organizuara nga Shkollat e Magjistraturës, duke marrë pjesë në 16 seminare/trajnime në total. Formularit të vetëvlerësimit i është bashkëlidhur vërtetimi i lëshuar nga Shkollat e Magjistraturës, si dhe kopje të certifikatave të trajnimeve për pjesëmarrjen në aktivitetet trajnuese të programit të trajnimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në formularin e vetëvlerësimit pjesëmarrjen në 2 trajnime të kryera disa brenda dhe disa jashtë periudhës së rivlerësimit nga agjenci të ndryshme të ligjit. Formularit të vetëvlerësimit i janë bashkëlidhur kopje të certifikatave, që të vërtetojnë kryerjen e këtyre trajnimeve.

¹⁰³ Sipas të dhënave që ndodhen në sektorin “Burimet njerëzore” pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

¹⁰⁴ Informacion i trajtuar nga KLP-ja në raportin profesional, si dhe dërguar edhe pranë Komisionit nga Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. *** prot., datë 29.6.2021 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 2.9.2021).

¹⁰⁵ Kallëzuesi ka pretenduar se prokurorja Rovena Zoto ka fshehur disa dokumente, që janë kërkesa që kallëzuesi u ka dërguar institucioneve vendore Lushnjë.

¹⁰⁶ Në vendimin e mosfillimit, prokurori ka arsyetuar se: “...nuk gjendemi para elementeve të ndonjë vepre penale konkrete të parashikuar nga legjislacioni penal, për të cilën të jetë në kompetencë të organit të akuzës zhvillimi i hetimeve. Nga rrethanat e parashtruara në këtë kallëzim rezulton se janë ngritur pretendime për mungesën e dokumenteve në një material hetimor të denoncuar nga kallëzuesi, pretendime lidhur me vendimmarrjet të marranë kushte konflikti interesi dhe në mungesë të verifikimeve të plota të dokumenteve të kallëzuesit. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat vlerëson se nuk ka kompetencë për shqyrtimin e pretendimeve të tilla dhe se ato duhet të shqyrtohen në rrugë gjyqësore në kuadër të ankimeve ndaj vendimmarrjeve përkatëse të prokurorit”.

të mosfillimit është ushtruar ankim dhe ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier¹⁰⁷.

39.3.4 Për subjektin e rivlerësimit, znj. Rovena Zoto është dërguar informacioni nga SHISH-i për Prokurorin e Përgjithshëm, me nr. *** prot., datë 27.3.2014, që është arkivuar në datën 13.6.2014 me shënimin “Trajtuar nga Dr. Inspektimit”¹⁰⁸. Vlerësimet e kryera nga Prokurori i Përgjithshëm për subjektin e rivlerësimit në vitet 2012 – 2016 janë “Shumë mirë”.

DENONCIME

40. Ndaj subjektit të rivlerësimit janë depozituar pranë Komisionit 3 denoncime. Pasi shqyrtoi secilin prej tyre, trupi gjykues administroi dosjet penale, shqyrtoi dhe analizozi me objektivitet dokumentacionin e administruar në dosje, si dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit dhe pas dërgimit të rezultateve të hetimit në lidhje me këto denoncime.

40.1 Denoncim nr. * prot., datë 16.6.2021, i shtetasit P.M**

Denoncuesi ka qenë debitor për një kredi të marrë prej tij në Bankën Tregtare Agrare. Agjencia e Tregtimit të Kredive ka marrë atributet e BTA-së, pra është bërë cedimi i kredisë nga BTA-ja tek ATK-ja dhe, në bazë të kërkesës së kësaj të fundit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për titullin ekzekutiv, marrëveshjen e huas së lidhur midis shtetasit P.M dhe BTA-së.

Në zbatim të urdhrin të ekzekutimit, midis ATK-së dhe përmbaruesit privat Z.SH është lidhur kontratë shërbimi dhe ky i fundit ka nisur procedurat e ekzekutimit. Pasi ka kryer njoftimin për ekzekutimin vullnetar, meqenëse detyrimi nuk është përmbushur vullnetarisht, përmbaruesi ka vendosur sekuestron konservative. Ndaj përmbaruesit privat ka bërë kallëzim debitori P.M, duke pretenduar se përmbaruesi, duke shfrytëzuar vendin e punës, i ka vjedhur atij shumën 424,095 lekë, pasi me kreditorët e ATK-së nuk merret shërbimi përmbarimor privat.

Pasi ka analizuar veprimet e përmbaruesit dhe bazën ligjore, subjekti i rivlerësimit ka arritur në përfundimin se veprimet e përmbaruesit gjyqësor privat, z. Z.SH, rezultojnë të mbështetura në ligjin procedural civil dhe nuk kanë elemente të asnjë vepre penale. Në përfundim, bazuar në nenin 290, shkronja “ç”¹⁰⁹, ka vendosur mosfillimin e procedimit për kallëzimin penal nr. *** të vitit 2015.

Nga informacioni i dërguar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier¹¹⁰, rezulton se ndaj vendimit të subjektit të rivlerësimit, datë 31.12.2015 “Për mosfillimin e procedimit penal” të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë nuk është paraqitur ankim.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë informoi¹¹¹ se shtetasi P.M i është drejtuar ILD-së me dy ankesa ndaj subjektit të rivlerësimit në lidhje me të njëjtin fakt objekt i këtij denoncimi. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur arkivimin e ankesës së parë¹¹², pasi nuk plotëson kushtet e pranueshmërisë së ankesës. Në këtë vendim, Inspektori, ndër të tjera, ka arsyetuar se referuar pretendimeve të ankuesit, konstatohet se ato në thelbin e tyre shprehin mosdakordësinë me vlerësimin që prokurori u bën fakteve dhe interpretimit ligjor. Në lidhje me ankesën e dytë është

¹⁰⁷ Me vendimin nr. *** , datë 28.6.2016.

¹⁰⁸ Informacioni i dërguar nga sektori i protokoll - arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme, me shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2019.

¹⁰⁹ Kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale ose kur del qartë që fakti nuk ekziston.

¹¹⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.5.2023 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 31.5.2023).

¹¹¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.7.2023 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 24.7.2023).

¹¹² Vendim nr. *** prot., datë 12.4.2021, i ILD-së.

vendosur arkivimi¹¹³, pasi ishte ankesë e përsëritur, që kishte të bënte me të njëjtin fakt si ankesa e parë.

Vlerësimi i Komisionit

Bazuar në pikën 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni analizon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerëson. Duke bërë paralelizmin e këtij parashikimi me rastin kur subjekti është prokuror, Komisioni, pasi shqyrtoi denoncimin dhe aktet përkatëse, vlerësoi se denoncimi ka të bëjë me fakte që lidhen me korrektësinë e vendimit të subjektit të rivlerësimit, rrethana të cilat nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni.

Gjithashtu, rezultoi se denoncuesi nuk e ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të subjektit, për të cilin ka paraqitur denoncimin objekt i këtij trajtimi.

Në përfundim, trupi gjykues, pasi analizoi sa më lart, çmoi se nuk u konstatuan problematika që të kenë sjellë cenim të të drejtave të palëve në proces apo shkelje të rënda procedurale, të cilat mund të sjellin cenimin e procesit dhe vlerësoi se nuk rezultuan problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit.

40.2 Denoncim nr. * prot, datë 26.3.2018, i shtetasit B.A**

Denoncuesi pretendon se subjekti ka kryer shkelje të rëndë, duke mos filluar procedimin penal që lidhet me falsifikimin e firmës së dëshmisë së trashëgimisë së nënës së tij. Ai pretendoi se nuk janë kryer verifikimet e nevojshme në lidhje me veprën penale, si ekspertiza e firmës dhe se personi në fjalë është analfabete. Gjithashtu, pretendon se prokurorja ka deklaruar se nëna e tij (e denoncuesit) ishte e shoqëruar në seancë gjyqësore, por pa deklaruar nga kush. Ai shton se prokurorja ka fshehur të vërtetën në lidhje me kallëzimin penal.

Komisioni administroi¹¹⁴ fashikullin e hetimit dhe vendimet gjyqësore në lidhje me rastin në fjalë, nga ku rezultoi se:

- Në datën 13.3.2013, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, me kallëzues shtetasin B.A, kundër shtetases L.A, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

- Në datën 4.4.2013, prokurorja e çështjes, subjekti i rivlerësimit Rovena Zoto, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, bazuar në nenin 290, shkronja “ç”¹¹⁵ dhe nenin 291¹¹⁶ të Kodit të Procedurës Penale, me arsyetimin se fakti i kallëzuar nuk përmban elementet e ndonjë vepre penale dhe, si rrjedhojë, nuk parashikohet nga ligji si veprë penale.

Ndaj vendimit të mosfillimit, shtetasi B.A (denoncuesi) ka ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe kjo e fundit, me vendimin nr. ***, datë 17.9.2013, ka vendosur rrëzimin e ankimit, si të pabazuar në ligj dhe në prova.

Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 3.12.2014, e cila ndër të tjera ka arsyetuar se: “...Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, si ka

¹¹³ Vendim nr. *** prot., datë 26.5.2021, i ILD-së.

¹¹⁴ Me shkresën e Prokurorisë nr. *** prot., datë 13.6.2023 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 15.6.2023).

¹¹⁵ “1. Procedimi penal nuk mund të fillojë kur: [...] ç) kur fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale ose kur del qartë që fakti nuk ekziston [...]”.

¹¹⁶ “Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit...”.

kryer një sërë veprimesh hetimore, duke pyetur me cilësinë e personave që mund të kishin dijeni rreth faktit shtetasit..., si dhe ka marrë si dokumente dosjet gjyqësore përkatëse, në të cilat ndodhen aktet e pretenduara si të falsifikuara prej ankuesit, ka vendosur në datën 4.4.2013 mosfillimin e procedimit penal, pasi fakti i kallëzuar nuk përmban elementet e ndonjë vepre penale... Prokuroria në arsyetimin e vendimit ka argumentuar se edhe sikur të provoheshin pretendimet e kallëzimitarit për veprimet e ndërmarra nga shtetasja e kallëzuar, këto veprime janë të parashkruara për efekt të zbatimit të nenit 66 të Kodit Penal dhe, rrjedhimisht, ndjekja penale nuk mund të ushtrohet...”.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues, pasi analizoi sa më lart, konstatoi se kjo çështje i është nënshtruar kontrollit gjyqësor në të dyja shkallët e gjykimit, duke mos u konstatuar mangësi apo probleme në veprimet e prokurorit, që të kenë sjellë cenim të të drejtave të palëve në proces.

40.3 Denoncim nr. * prot., datë 29.12.2017, i shtetasit A.RR**

Denoncimi është bërë ndaj 35 subjekteve të rivlerësimit, ndër të cilët edhe subjekti Rovena Zoto. Denoncuesi nuk ka parashtruar asnjë pretendim konkret ndaj subjektit dhe nuk përmbush kriteret e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: “2. *Informacioni duhet të përmbajë përshkrimin e të dhënave për të vlerësuar shkëlqjen ligjore sipas kriterëve të rivlerësimit, veçanërisht për veprimin ose praktikën e dyshuar, pasojat ligjore, rrethanat për faktet që krijojnë bindjen se ka pasur shkëlqje ligjore, si dhe të dhënat mbi identitetin e personit”.*

GJETJE TË TJERA TË KOMISIONIT

41. Komisioni, në kuadër të zhvillimit të një hetimi të plotë e gjithëpërfshirës, hetoi lidhur me disa informacione të marra nga institucionet ligjzbatuese dhe administroi¹¹⁷ fashikujt e hetimit në lidhje me 3 çështje penale të hetuara nga subjekti i rivlerësimit, nga të cilat rezultuan problematika lidhur me:

41.1 Procedimi penal ndaj të pandehurve E.H, S.V dhe K.B

Rrethanat e çështjes

41.1.1 Në lagjen “****”, Lushnjë, shërbimet e policisë kanë kryer kontrollin e një mjeti, në të cilin udhëtonin shtetasit S.V, K.B dhe E.H. Gjatë kontrollit, poshtë sediljes ku qëndronte shtetasi K.B është gjetur një mjet grirës, brenda të cilit kishte material bimor të grirë me peshë 1 gram, që rezultoi të ishte *cannabis sativa*, ndërsa nën tapicerinë ku qëndronte i ulur shtetasi E.H është gjetur një qese plastike e mbushur me lëndë bimore me peshë 5.60 gram, që rezultoi të ishte *cannabis sativa*.

41.1.2 Gjithashtu, shërbimet e policisë gjyqësore kanë ushtruar kontroll në shtëpinë e shtetasit E.H, gjatë të cilit u gjet dhe u sekuestrua në cilësinë e provës materiale një armë zjarri automatike. Shtetasi E.H, i pyetur nga prokurori A.D¹¹⁸ (i cili ishte prokurori i çështjes para se ajo t’i kalonte në datën 31.10.2013 subjektit të rivlerësimit Rovena Zoto), është shprehur: “*Unë e pranoj se lënda narkotike e gjetur me qese në makinë, së bashku me grirësen, si dhe arma e zjarrit e gjetur në shtëpinë time, janë të miat. Armën e kam gjetur para rreth 10-15 ditësh në afërsi të M të A”.*

41.1.3 Mbi bazën e materialit kallëzues referuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Fier, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 9.9.2013, për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike”, e kryer në bashkëpunim dhe “Prodhimi

¹¹⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 4.7.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 6.7.2023).

¹¹⁸ Procesverbal datë 9.9.2013.

dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga nenet 283/2 dhe 278/3 të Kodit Penal.

41.1.4 Duke qenë se personat e arrestuar kanë pretenduar se ishin përdorues të lëndëve narkotike, janë kryer ekspertimet toksikologjike të mostrave të urinës, nga të cilat rezultoi se ata ishin përdorues. Gjithashtu, është kryer edhe ekspertimi toksikologjiko-ligjor, nga i cili ka rezultuar se sasinë e gjetura nuk konsiderohen doza të vogla për përdorim vetjak.

41.1.5 Sipas shpjegimeve të dhëna nga të arrestuarit, sasinë e lëndës narkotike e ka blerë shtetasi E.H gjatë një momenti kur kanë ndaluar automjetin dhe, pasi është kthyer në automjetin që drejtohej nga shtetasi S.V, ai i ka vënë në dijeni dy të tjerët se kishte blerë hashash dhe do ndalonin për të pirë nga një cigare, kur janë ndaluar nga policia.

41.1.6 Në datën 9.9.2013, drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka urdhëruar të kryhet regjistrimi i procedimit penal nr. *** për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, “Armëmbajtje pa leje” dhe “Drejtim mjeti pa dëshmi”, parashikuar nga nenet 283/2, 278/3 dhe 291 të Kodit Penal. Me hetimin e çështjes është ngarkuar prokurori A.D.

41.1.7 Prokurori A.D në datën 20.9.2013 ka vendosur ndarjen e procedimit penal nr. ***, datë 9.9.2013, regjistruar në ngarkim të shtetasve S.V, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Drejtimi i mjetit në mënyrë të parregullt”; K.B dhe E.H, persona të dyshuar për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të kryer në bashkëpunim dhe krijimin e një procedimi penal të ri me autor të njohur, me nr. *** të vitit 2013, në ngarkim të shtetasit S.V, për veprën penale “Drejtimi i mjetit në mënyrë të parregullt”.

41.1.8 Në datën 31.10.2013 është urdhëruar zëvendësimi i prokurorit A. D me prokuroren Rovena Zoto.

41.1.9 Në datën 9.12.2013, prokurorja Rovena Zoto ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimeve për një periudhë 2-mujore, për të kryer disa veprime të tjera hetimore, ndër të cilat edhe pyetja në cilësinë e të pandehurve të shtetasve E.H dhe K.B.

41.1.10 Në datën 20.1.2014, prokurorja Rovena Zoto ka urdhëruar që në regjistrin e njoftimit të veprave penale, për procedimin penal nr. ***, viti 2013, të shënohet emri i personit nën hetim S.V, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Moskallëzimi i krimit”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal. Ajo ka arsyetuar se nga hetimi ka rezultuar që ka të dhëna të mjaftueshme për të dyshuar se nga shtetasi S.V, i cili ka qenë drejtuesi i mjetit ku është gjetur lënda narkotike e sekuestruar, janë konsumuar elementet e veprës penale “Moskallëzimi i krimit”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal, pasi ky shtetas, edhe pasi është vënë në dijeni të blerjes së lëndës narkotike, nuk ka informuar për këtë fakt organet kompetente.

41.1.11 Në datën 29.1.2014, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të marrë në cilësinë e të pandehurit personin nën hetim S.V dhe t’i njoftojë akuzën për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”.

41.1.12 Në datën 30.1.2014, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të marrë në cilësinë e të pandehurit personin nën hetim K.B dhe t’i njoftojë akuzën për veprën penale “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

41.1.13 Në datën 31.1.2014, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të marrë në cilësinë e të pandehurit personin nën hetim E.H dhe t’i njoftojë akuzën për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuara nga nenet 283/1 dhe 278/3 të Kodit Penal. Ky shtetas në datën 31.1.2014 ka deklaruar para OPGJ-së: *“Akuzën e dëgjova, e kuptova dhe e pranoj. Në lidhje me këtë akuzë, deklaroj se u*

qëndroj deklarimeve të mia të mëparshme¹¹⁹, ku theksoj se grirësja e hashashit dhe qeska me hashash kanë qenë të miat. Armën kisha rreth 2 javë që e kisha gjetur te kthesa e M. të A. dhe e fsheha në shtëpi”.

41.1.14 Në urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore, datë 20.1.2014, subjekti Rovena Zoto ka shpjeguar ndër të tjera: *“...armë zjarri automatike, të cilën shtetasi E.H pranoi se ishte e tija dhe se e kishte gjetur para disa ditësh në afërsi të M. të A. Nga akti i ekspertimit teknik i armës së zjarrit... në konkluzion thuhet se: “arma objekt ekspertimi është armë zjarri automatik... Automatik është në gjendje të rregullt teknike dhe me të realizohet qitje normalisht dhe pa pengesa”.* (Po të njëjtën gjë subjekti ka shprehur edhe në konkluzionet përfundimtare depozituar në gjykatë).

41.1.15 Në datën 5.2.2014, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë gjykimin e çështjes nr. ***, në ngarkim të të pandehurve E.H, K.B dhe S.V sipas akuzave të parashtruara në pjesën hyrëse të kësaj kërkesë. Në pjesën hyrëse, ku janë specifikuar të pandehurit, për të dy të pandehurit E.H dhe K.B është përcaktuar vepra penale e parashikuar në nenin 283/1 të Kodit Penal.

41.1.16 Në pjesën shpjeguese të kërkesës për gjykimin e çështjes, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, subjekti ka sqaruar: *“Në përfundim të hetimit të procedimit penal nr. ***, regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lushnjë në datën 9.2.2013, ka rezultuar e provuar sa më poshtë: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, mbi bazën e materialit kallëzues... ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 9.9.2013 për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike” e kryer në bashkëpunim dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuara nga nenet 283/2 dhe 278/3 të Kodit Penal, në ngarkim të personave nën hetim E.H dhe K.B...”.*

41.1.17 Më tej, përgjatë pjesës arsyetuese të kërkesës, subjekti është shprehur se rezulton e provuar se i pandehuri E.H ka konsumuar të gjitha elementet e veprave penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuara nga nenet 283/1 dhe 278/3 të Kodit Penal. Në lidhje me shtetasin K.B, subjekti është shprehur se rezulton e provuar se i pandehuri K.B ka konsumuar të gjitha elementet e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

41.1.18 Kjo çështje është gjykuar me procedurën e gjykimin të shkurtuar në bazë të neneve 403 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, pasi të pandehurit në seancë gjyqësore kërkuan gjykim të shkurtuar dhe kjo kërkesë u pranua nga gjykata.

41.1.19 Në konkluzionet përfundimtare, subjekti i rivlerësimit përsëri ka shpjeguar se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 9.9.2013, për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, e kryer në bashkëpunim dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuara nga nenet 238/2 e 237/3 dhe në përfundim ka kërkuar deklarinin fajtor të të pandehurve, por ka kërkuar deklarinin fajtor jo më për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 238/2, por për kryerjen e kësaj vepre sipas nenit 238/1, pra jo në rrethanën cilësuese të bashkëpunimit.

41.1.20 As në vendimin për njoftimin e akuzës të pandehurve, as në pjesën arsyetuese të kërkesës për gjykim dhe as në atë të konkluzioneve përfundimtare nuk ka asnjë arsyetim mbi arsyen e ndryshimit të cilësimit juridik të veprës, nga vepër e kryer në bashkëpunim si rrethanë cilësuese e

¹¹⁹ Edhe sipas procesverbalit mbajtur nga prokurori A.D në datën 9.9.2013, shtetasi E.H ka bërë të njëjtin deklarin.

saj, në vepër të kryer pa këtë rrethanë cilësuese.

- Dënimi i parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal (kryerja e veprës në bashkëpunim) është burgim nga 7 deri në 15 vite.
- Dënimi i parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal është burgim nga 5 deri në 10 vjet.
- Dënimi i parashikuar nga neni 278/3¹²⁰ (me ndryshimet e bëra deri në kohën e kryerjes së veprës, me ligjin nr. 144/2013) ishte nga 1 deri në 5 vjet.

41.1.21 Lloji dhe masa e dënimit të kërkuar nga prokurorja për secilin prej tyre, si dhe disponimet e gjykatave janë si më poshtë:

➤ **Në lidhje me të pandehurin E.H (hetuar dhe gjykuar me masë sigurimi “Arrest në burg”)**

Në konkluzionet përfundimtare paraqitur në gjykatë, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar:

- deklarin fajtor të të pandehurit E.H për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 vite burgim;
- deklarin fajtor të të pandehurit për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, parashikuar nga neni 278/3 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 vit burg;
- në zbatim të nenit 55/4 të Kodit Penal, t’i caktohet një dënim i vetëm, i cili të jetë sa masa e dënimit më të rëndë të caktuar, duke e dënuar të pandehurin me 5 vjet burgim;
- në aplikim të gjykimit të shkurtuar, dënimin e tij përfundimisht me 3 vjet e 4 muaj burgim.

I pandehuri E.H në gjykim është përfaqësuar me avokatë të caktuar kryesisht dhe ka kërkuar *“Dënimin nën minimumin e parashikuar nga ligji apo të urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për pjesën e pavuajtur; Pendim dhe kërkoj nga gjykata të më jepet një mundësi”*.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka vendosur¹²¹ deklarin fajtor të të pandehurit E.H për dy veprat penale si më lart dhe dënimin e tij përfundimisht me 5 vite burgim dhe me 1 vit burgim për secilën prej tyre; në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve, dënimin e tij me 5 vite burgim. Në aplikim të gjykimit të shkurtuar, dënimin e tij përfundimisht me 3 vjet e 4 muaj burgim.

Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë.

➤ **Në lidhje me të pandehurin S.V (hetuar pa masë sigurimi)**

Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar dënimin e tij me 3 muaj burgim për veprën penale “Moskallëzimi i krimit” dhe, në aplikim në nenit 406¹²² të Kodit të Procedurës Penale, dënimin e tij përfundimisht me 2 muaj burgim.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka vendosur¹²³ deklarin fajtor të të pandehurit për veprën penale “Moskallëzimi i krimit” dhe dënimin e tij me 2 vite burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, meqenëse u procedua me gjykim të shkurtuar, gjykata uli dënimin me 1/3, duke e dënuar përfundimisht me 1 vit e 4 muaj burgim.

¹²³ Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit.

¹²¹ Vendimi nr. ***, datë 3.6.2014.

¹²² Vendimi i dënimit në rastin e gjykimit të shkurtuar.

¹²³ Vendimi nr. ***, datë 3.6.2014.

Gjykata e Apelit Vlorë¹²⁴ e ka lënë në fuqi këtë vendim për sa i përket cilësimit juridik dhe fajësisë për të pandehurin S.V dhe ndryshimin e tij sa i përket masës së dënimit për këtë të pandehur, duke vendosur përfundimisht dënimin e tij me 2 muaj burgim.

➤ **Në lidhje me të pandehurin K.B (hetuar dhe gjykuar me masë sigurimi “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”)**

Në konkluzionet përfundimtare paraqitur në gjykatë, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar:

- deklarimin fajtor të të pandehurit K.B për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 vite burgim;
- në aplikim të gjykimit të shkurtuar, dënimin e tij përfundimisht me 3 vjet e 4 muaj burgim;
- në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, duke marrë parasysh rrezikshmërinë e ulët të autorit, sasinë e vogël të lëndës narkotike të sekuestruar, kushtet e tij shëndetësore¹²⁵ dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, ka kërkuar nga gjykata pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë për një periudhë 3-vjeçare, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale;
- në zbatim të nenit 60, pika 11 e Kodit Penal, duke marrë parasysh llojin e veprës së kryer nga i pandehuri dhe faktin që është përdorues i lëndëve narkotike, ka kërkuar detyrimin e tij që gjatë kohës së provës të mjekohet në një institucion mjekësor për varësinë nga lëndët narkotike.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka vendosur¹²⁶ deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe dënimin e tij me 5 vite burgim. Në aplikim të gjykimit të shkurtuar, dënimin e tij me 3 vjet e 4 muaj burgim.

Sa u përket kërkesave për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë për një periudhë prej 3 vjetësh, gjykata ka çmuar se nuk plotësohen kriteret ligjore për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim të parashikuara në nenin 59 të Kodit Penal, duke arsyetuar se: *“Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë e autorit të veprës penale përfshihet në kategorinë e alternativave të dënimit me burgim, që në konceptin e politikës penale synon të zgjerojë mundësitë e edukimit dhe rehabilitimit në shoqëri të personit që ka kryer veprën penale, në forma të ndryshme nga ajo e kufizimit të lirisë së tij personale, duke paraqitur një dënim më të zbutur të autorit të veprës penale... Zbatimi i nenit 59 duhet të aplikohet vetëm nëse plotësohen këto dy kushte:*

1. *Dënimi përfundimtar i caktuar prej gjykatës nuk duhet të jetë më shumë se 5 vjet;*
2. *Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezulton se ekziston një nga rrethanat e mëposhtme:*
 - *I pandehuri paraqet rrezikshmëri të pakët shoqëror. Rrezikshmëria shoqërore e ulët e autorit është një kusht që duhet të vlerësohet nga gjykata gjatë procesit gjyqësor, duke pasur parasysh personin konkret, gjendjen e tij shoqërore dhe probleme që lidhen me personalitetin e tij;*
 - *I pandehuri është i mitur apo i moshuar;*
 - *I pandehuri ka kushte mendore apo shëndetësore të veçanta;*
 - *I pandehuri ka detyrime për punën, arsimimin, kualifikimin ose aftësimin profesional;*
 - *I pandehuri ka përgjegjësi thelbësore për familjen;*

¹²⁴ Me vendimin nr. ***, datë 3.12.2014 (shihni shënimin e kancelarit në fund të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë).

¹²⁵ Sa u përket kushteve shëndetësore ka arsyetuar: *“Rezulton se i pandehuri ka pësuar traumë në retinën e syrit të majtë si pasojë e një pjese metalike që ka përshtuar syrin”* (vërtetuar ky fakt me raportin mjekësor të datës 17.2.2014, lëshuar nga prof.dr. N. T) (shihni faqen 6 të konkluzioneve përfundimtare).

¹²⁶ Vendimi nr. ***, datë 3.6.2014.

- *I pandehuri e ka kryer veprën penale në kushtet e disa rrethanave lehtësuese;*
- *I pandehuri ka pasur një sjellje shumë të mirë pas kryerjes së veprës penale.*

Sa më sipër, si dhe nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata çmon se pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim nuk justifikohet, pasi të dyja kushtet nuk plotësohen në mënyrë kumulative...”.

Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë¹²⁷.

Në përfundim të hetimit, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës lidhur me sa më poshtë:

- Subjekti nuk ka argumentuar ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale për të pandehurit E.H dhe K.B nga neni 283/2 i Kodit Penal, sikurse është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në nenin 283/1 të Kodit Penal, referuar në vendimin e njoftimit të akuzës të pandehurit, në kërkesën për gjykim dhe në konkluzionet përfundimtare të paraqitura nga subjekti në gjykatë.
- Duket se subjekti i rivlerësimit ka favorizuar të pandehurin K.B, duke kërkuar për të pezullim të ekzekutimit të dënimit me burgim, kur nuk plotësoheshin kushtet ligjore për pezullim.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

42. Subjekti i rivlerësimit, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe në seancë gjyqësore, ndër të tjera ka parashtruar se: *“...Bazuar në qëndrimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara, në mungesë të provave që i pandehuri K.B e mbante lëndën narkotike për ta shitur apo shpërndarë, për të përcaktuar nëse sasia e lëndës narkotike që i është gjetur, përbënte dozë të vogël për përdorim vetjak, është vendosur kryerja e ekspertimit toksikologjiko-ligjor, nga ka rezultuar se kjo sasi lënde nuk mund të konsumohej menjëherë.*

- 1. Gjithashtu, rrezikshmëria e pakët e këtij të pandehuri është konstatuar që në fazën e kërkesës për caktimin e masës së sigurimit, pasi prokurori A.D ka kërkuar për këtë të pandehur masën e sigurimit “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”, ndërsa për dy të pandehurit e tjerë është kërkuar masa e sigurisë “Arrest në burg”.*
- 2. Zbatimi i alternativës së ekzekutimit me burgim është kërkuar pasi është analizuar se plotësoheshin kushte të tilla, si sasia e vogël e lëndës narkotike që posedonte i pandehuri, lloji i lëndës narkotike cannabis sativa, që konsiderohet si më pak e dëmshme ndër lëndët narkotike, fakti që i pandehuri ishte përdorues i kësaj lënde narkotike, problemet shëndetësore – trauma në syrin e majtë (vërtetuar me raport mjekësor të datës 17.2.2023), të qenët i padënuar, mosha e re – 19 vjeç, pra, i sapodalë nga mituria, i pandehuri ka shfaqur pendim të thellë për veprimet e kryera prej tij (rrethanë lehtësuese sipas nenit 47/ç të Kodit Penal).*
- 3. Gjykata e Shkallës së Parë nuk ka qenë unanime sa i përket mosaplikimit të nenit 59 për të pandehurin K.B, sa kohë që ka dhe mendim pakice. Gjithashtu, në interpretim të nenit 59 të Kodit Penal, ndryshe nga sa argëton shumica e trupës gjyqësore, nuk kërkohet që kushtet e parashikuara në këtë dispozitë të plotësohen në mënyrë kumulative.*
- 4. Pasi vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë është ankimuar nga të pandehurit në Gjykatën e Apelit Vlorë, kjo e fundit me vendimin nr. ***, datë 3.12.2014, ka vendosur “lënie në fuqi të vendimit nr. ***, datë 3.6.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë për sa i*

¹²⁷ Vendimi nr. ***, datë 3.12.2014 (shihni shënimin e kancelarit në fund të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë).

përket cilësimin juridik dhe fajësisë për të tre të pandehurit, për llojin dhe masën e dënimit për të pandehurin E.H... Ndryshimin e vendimit të mësipërm në këtë mënyrë: “Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për të pandehurit K.B dhe S.V, me kusht që të mos kryejnë veprë tjetër penale për një periudhë prej 3 vjetësh.

5. *Ky vendim i formës së prerë vërteton plotësisht se të gjitha kërkesat e ngritura nga prokurori i Shkallës së Parë (mbështetur edhe nga prokurori i Apelit) për të pandehurin K.B kanë qenë të bazuara në ligj dhe në prova”.*

Vlerësimi i Komisionit

43. Trupi gjykues çmon se qëndrimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë çështje, dhe kryesisht lidhur me kërkesën për aplikim të nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale, nuk është i bazuar në ligj dhe në praktikën gjyqësore. Nga përmbajtja e dispozitës del e qartë se nga ana e prokurorit duhet të vlerësohen nëse plotësohen në mënyrë kumulative kërkesat e parashikuara në nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale.

44. Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se i parë në raport me vlerësimin tërësor të subjektit, ky rast nuk mund të prodhojë në mënyrë proporcionale vendosjen e masës së shkarkimit nga detyra, sipas pikës 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Rovena Zoto, ka plotësuar së bashku kushtet si vijon:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Rovena Zoto, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Vendimi u shpall në Tiranë, në datën 20.11.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesuese

Alma FASKAJ
Relatore

Xhensila PINE
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka